



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe
Jakup Krasniqit**

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 31 gusht 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së
dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të
Akuzuarve**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagendra

TABELA E PËRMBAJTJES

I. HISTORIKU PROCEDURAL.....	3
II. PARASHTRIMET	6
III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE	10
A. MOCIONET PARAPRAKE	10
B. MANDATI KOHOR I DHS-së	11
C. LIGJSHMËRIA E HETIMIT TË ZPS-së.....	11
D. E DREJTA PËR T’U GJYKUAR NGA NJË GJYKATË E THEMELUAR ME LIGJ 12	
E. E DREJTA PËT T’U GJYKUAR NGA NJË GJYKATË E PAVARUR DHE E PAANSHME.....	13
F. E DREJTA PËR TË MOS U GJYKUAR NGA NJË GJYKATË E JASHTËZAKONSHME	16
G. E DREJTA PËR T’U KONSIDERUAR I PAFAJSHËM DHE PËR T’U GJYKUAR BREND A NJË KOHE TË ARSYESHME	16
H. REFERIMET PËR DHOMËN E SPECIALIZUAR TË GJYKATËS KUSHTETUESE.....	17
IV. DISKUTIM	17
A. ÇËSHTJE PARAPRAKE.....	17
1. A janë kundërshtimet e ngritura nga Mbrojtja brenda fushëveprimit të rregullës 97(1)(a) të Rregullores	17
2. Kërkesa për seancë publike	20
B. Kundërshtimet lidhur me Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së.....	21
1. Mandati kohor i DHS-së	21
2. Ligjshmëria e hetimit të ZPS-së	24
C. SHKELJET E PRETENDUARA TË TË DREJTAVE KUSHTETUESE	28
1. E drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e themeluar me ligj.....	30
2. E drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme	33
3. E drejta për të mos u gjykuar nga një gjykatë e jashtëzakonshme	46
4. E drejta për t’u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme.....	48

5.	E drejta për t'u konsideruar i pafajshëm.....	54
6.	Përfundim	59
D.	KËRKESA E VESELIT PËR REFERIM DHSGJK-së	59
V.	VENDIM.....	60

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenet 31, 103, 116 dhe 162 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta"), nenet 3, 19, 21, 25, 27, 28, 30, 31, 32, 33, 39, 49 dhe 63 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 4, 21, 22, 47, 75 dhe 97 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën ("Aktakuza e Konfirmuar") kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit (përkatësisht "z. Thaçi", "z. Veseli", "z. Selimi" dhe "z. Krasniqi", dhe së bashku "të akuzuarit" ose "Mbrojtja").²

2. Më 30 tetor 2020, Prokurori i Specializuar paraqiti aktakuzën e konfirmuar ("Aktakuza e Konfirmuar"),³ me redaktimet e autorizuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁴

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026/CONF/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit për Konfirmimin e aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 nëntor 2020, F00026/RED.

³ KSC-BC-2020-06, F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me të*, 30 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe me Shtojcat 2-3, konfidenciale. Një version i korrigjuar më tej i aktakuzës së konfirmuar që korrigjoi disa gabime shtypi u dorëzua më 4 nëntor 2020, si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (F00045/A01), në versionin e redaktuar konfidencial (F00045/A02), dhe në versionin e redaktuar publik (F00045/A03). Versioni më pak i redaktuar i F00045/A02 u dorëzua më 11 dhjetor 2020, F00134, konfidencial.

⁴ Vendimi i Konfirmimit, para. 521(c)-(d).

3. Më 4 dhe 5 nëntor 2020, me urdhër të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,⁵ të akuzuarit u arrestuan⁶ dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS") në Hagë, Holandë.⁷

4. Më 12 mars 2021, z. Thaçi dorëzoi një mocion me anë të të cilit kërkonte hedhjen poshtë të Aktakuzës së Konfirmuar për mungesë juridiksioni ("Mocioni i Thaçit mbi ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së")⁸ si dhe një mocion tjetër që ngrinte kundërshtime në lidhje me ligjshmërinë e DHS-së dhe shkeljen e pretenduar të disa të drejtave të tij ("Mocioni i Thaçit").⁹

⁵ KSC-BC-2020-06, F00027, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhëra Transferimi*, 26 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcat 1-8, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versionet e korrigjuara të shtojcave 7 dhe 8 u dorëzuan më 28 tetor 2020, F00027/A07/COR dhe F00027/A08/COR. Versionet e redaktuara publike të shtojcave (F00027/A01/RED, F00027/A02/RED, F00027/A03/RED, F00027/A04/RED, F00027/A05/RED, F00027/A06/RED, F00027/A07/COR/RED, F00027/A08/COR/RED) dhe të vendimit (F00027/RED) u dorëzuan përkatësisht më 5 nëntor 2020 dhe 26 nëntor 2020.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00044, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Jakup Krasniqit, sipas Rregullës 55(4)*, 4 nëntor 2020, publik; F00049, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Rexhep Selimit, sipas Rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik; F00050, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Kadri Veselit, sipas Rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik; F00051, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Hashim Thaçit, sipas Rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00048, Administratorja, *Njoftimi i Pranimit të Jakup Krasniqit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 4 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publike; F00053, Administratorja, *Njoftimi i Pranimit të Hashim Thaçit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe mbi Emërimin e Mbrojtësit*, 5 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publike dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F00054, Administratorja, *Njoftimi i Pranimit të Kadri Veselit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe mbi Emërimin e Mbrojtësit*, 5 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publike dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F00055, Administratorja, *Njoftimi i Pranimit të Rexhep Selimit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 5 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publike.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00216, Mbrojtja e z. Thaçi, *Mocion Paraprak për Rrëzimin e Aktakuzës për shkak të Mungesës së Juridiksionit*, 12 mars 2021, publik. Në këtë vendim do të trajtohen argumentet e z. Thaçi në lidhje me mandatin e përkohshëm të DHS-së dhe ligjshmërinë e hetimit të ZPS-së. Mocioni i Thaçit në lidhje me ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së, para. 44-59. Argumentet e tjera që përmban ky mocion janë trajtuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vendimin e nxjerrë më 22 korrik 2021, *shih* KSC-BC-2020-06, F00412, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet që ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara ("Vendimi mbi Mocionet për Juridiksionin")*, 22 korrik 2021, publik.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00217, Mbrojtja e z. Thaçi, *Mocion që Kundërshton Juridiksionin mbi Bazën e Shkeljes së Të Drejtave Themelore të Mishëruara në Kushtetutë*, 12 mars 2021, publik.

5. Më 15 mars 2021, edhe z. Selimi¹⁰ dhe z. Veseli¹¹ dorëzuan mocione që ngrinin kundërshtime në lidhje me ligjshmërinë e DHS-së dhe shkeljen e pretenduar të disa të drejtave të tyre (përkatësisht, “Mocioni i Selimit” dhe “Mocioni i Veselit”).

6. Më 23 prill 2021, në përputhje me afatin e përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,¹² Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi dy përgjigje përmbledhëse që, ndër të tjera, kishin të bënin me parashtrimet e dorëzuara nga z. Thaçi, z. Selimi dhe z. Veseli lidhur me ligjshmërinë e DHS-së dhe shkeljet e pretenduara të të drejtave të tyre.¹³

7. Më 14 dhe 17 maj 2021, në përputhje me afatet përkatëse të përcaktuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,¹⁴ z. Thaçi,¹⁵ z. Selimi¹⁶ dhe z. Veseli¹⁷ dorëzuan

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00219, Mbrojtja e z. Selimi, *Mocion Paraprak për Rrëzimin e Aktakuzës për shkak të Mungesës së Juridiksionit – Diskriminim*, 15 mars 2021, publik.

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00224, Mbrojtja e z. Veseli, *Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Kadri Veselit që Kundërshton Juridiksionin mbi Bazën e Shkeljeve të Kushtetutës*, 15 mars 2021, publik. Në këtë vendim do të trajtohen paragrafët 1-12, 20-21 të mocionit të Veselit. Parashtrimet e z. Veseli lidhur me dispozitat ligjore përkatëse janë trajtuar në Vendimin mbi Mocionet lidhur me Juridiksionin.

¹² KSC-BC-2020-06, Transkript (rish), 24 mars 2021 (“Transkripti i datës 24 mars 2021”), publik, f. 391, rreshtat 11-18.

¹³ KSC-BC-2020-06, F00259, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocioneve Paraprake në lidhje me Raportin e Këshillit të Evropës, Afatin e Hetimit dhe Mandatin Kohor* (“Përgjigja e ZPS-së F259”), 23 prill 2021, publike; F00260, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocioneve Paraprake në lidhje me Statusin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Pretendimeve për Shkelje të Të Drejtave* (“Përgjigja e ZPS-së F260”), 23 prill 2021, publike. Parashtrimet në lidhje me juridiksionin lëndor dhe Raportin e Këshillit të Evropës janë trajtuar në Vendimin mbi Mocionet në lidhje me Juridiksionin, para. 107-142.

¹⁴ Transkripti i datës 24 mars 2021, faqja 391, rreshtat 11-18; KSC-BC-2020-06, F00296, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Ndryshimin e Afatit*, 14 maj 2021, publik.

¹⁵ KSC-BC-2020-06, F00304, Mbrojtja e z. Thaçi, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë për Mocionet Paraprake në lidhje me Raportin e Këshillit të Evropës, Afatin e Hetimit dhe Mandatin kohor* (“Kundërpërgjigja e Thaçit ndaj F259”), 14 maj 2021, publike; F00305, Mbrojtja e z. Thaçi, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë për Mocionet Paraprake në lidhje me Statusin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Pretendimet për Shkelje të Të Drejtave* (“Kundërpërgjigja e Thaçit ndaj F260”), 14 maj 2021, publike.

¹⁶ KSC-BC-2020-06, F00307, Mbrojtja e z. Selimi, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë për Mocionet Paraprake në lidhje me Statusin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Pretendimet për Shkelje të Të Drejtave* (“Kundërpërgjigja e Selimit”), 14 maj 2021, publike.

¹⁷ KSC-BC-2020-06, F00308, Mbrojtja e z. Veseli, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë për Mocionin Paraprak që Kundërshton Juridiksionin mbi Bazën e Shkeljeve të Kushtetutës* (“Kundërpërgjigja e Veselit”), 17 maj 2021, publike.

kundërpërgjigjet e tyre.

II. PARASHTRIMET

8. Z. Thaçi parashtroi se mandati kohor i DHS-së dhe ZPS-së ka përfunduar,¹⁸ dhe se ZPS-ja nuk ka bazë kushtetuese ose ligjore për të kryer hetime të reja të tjera, pasi afati i përcaktuar për kryerjen e këtyre hetimeve ishte konsumuar nga Task Forca Hetimore Speciale ("TFHS").¹⁹ Gjithashtu, z. Thaçi parashtroi se e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një kohe të arsyeshme,²⁰ e drejta e tij për t'u konsideruar i pafajshëm,²¹ si dhe e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj,²² janë shkelur.²³ Z. Thaçi argumenton se pesha dhe karakteri kumulativ i këtyre shkeljeve shkaktojnë një pengesë ligjore për juridiksionin dhe kjo bën të pamangshme hedhjen poshtë të akuzave kundër tij dhe lirimin e tij.²⁴ Z. Thaçi pretendon se i vetmi mjet juridik efektiv në dispozicion është refuzimi nga DHS-ja i ushtrimit të juridiksionit.²⁵

9. Z. Selimi parashtroi se struktura dhe përbërja e personelit të DHS-së është në kundërshtim me themelimin dhe funksionimin e duhur të DHS-së si një gjykatë vendore e Kosovës, duke tejkaluar si rrjedhim kompetencat që i jep Kushtetuta dhe duke shkelur nenin 14 të Konventës (Evropiane) për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("KEDNJ").²⁶ Z. Selimi më tej kërkon që të mbahet një seancë gojore për këto tema.²⁷

¹⁸ Mocioni i Thaçit mbi Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së, para. 44-52.

¹⁹ Mocioni i Thaçit mbi Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së, para. 53-59.

²⁰ Mocioni i Thaçit, para. 7-14.

²¹ Mocioni i Thaçit, para. 30-35.

²² Mocioni i Thaçit, para. 36-51.

²³ Mocioni i Thaçit, para. 1, 52-53.

²⁴ Mocioni i Thaçit, para. 2.

²⁵ Mocioni i Thaçit, para. 54.

²⁶ Mocioni i Selimit, para. 2, 5-19.

²⁷ Mocioni i Selimit, para. 20.

10. Z. Veseli parashtroi se Ligji është *ultra vires* dhe ka cenuar thelbësisht parimin e ligjshmërisë duke e kthyer DHS-në *de facto* në një gjykatë të jashtëzakonshme në vend që të ishte një gjykatë e specializuar, në kundërshtim me nenin 103(7) të Kushtetutës.²⁸

Z. Veseli pretendon se, megjithëse Gjykata Kushtetuese e Kosovës ("GJKK") ka shqyrtuar tashmë nëse krijimi i DHS-së ishte në kundërshtim me nenin 103(7) të Kushtetutës,²⁹ ajo e bëri këtë në mënyrë të parakohshme sepse nuk bëri vlerësim të Ligjit.³⁰ Z. Veseli parashtroi se tani ekzistojnë arsye bindëse për të rishqyrtuar konstatimin e GJKK-së, dhe, rrjedhimisht, kërkon që kjo çështje t'i referohet Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("DHSGJK").³¹

11. ZPS-ja përgjigjet se parashtimet e z. Thaçi në lidhje me periudhën e lejuar për kryerjen e hetimeve penale³² dhe mandatin kohor të DHS-së³³ janë të pathemelta pasi ato mbështeten në dispozita ligjore të pazbatueshme dhe shpërfillin konstatime detyruese të DHSGJK-së.³⁴ ZPS-ja është e mendimit se parashtimet e Mbrojtjes duhet të hidhen poshtë në tërësi.³⁵

12. Sa u përket shkeljeve të pretenduara të të drejtave të të akuzuarve, si e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj,³⁶ e drejta për t'u konsideruar i pafajshëm,³⁷ dhe e drejta për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme,³⁸ ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja nuk ka provuar se ka pasur shkelje të standardeve përkatëse të të drejtave të njeriut dhe se parashtimet e saj në këtë drejtim

²⁸ Mocioni i Veselit, para. 1-2, 5-20.

²⁹ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i Amendamentit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me Shkresën nr. 05-433/DO-318, KO 26/15 ("Aktgjykimi i GJKK-së")*, 15 prill 2015.

³⁰ Mocioni i Veselit, para. 3.

³¹ Mocioni i Veselit, para. 4, 21.

³² Përgjigja e ZPS-së F259, para. 23-29.

³³ Përgjigja e ZPS-së F259, para. 30-32.

³⁴ Përgjigja e ZPS-së F259, para. 2.

³⁵ Përgjigja e ZPS-së F259, para. 33.

³⁶ Përgjigja e ZPS-së F260, para. 3-22.

³⁷ Përgjigja e ZPS-së F260, para. 29-33.

³⁸ Përgjigja e ZPS-së F260, para. 34-42.

duhet të hidhen poshtë në tërësi.³⁹ ZPS-ja parashtron se sidoqoftë, gjykata mund të justifikojë mosushtrimin e juridiksionit të saj vetëm në raste të jashtëzakonshme kur kanë ndodhur shkelje shumë të rënda të të drejtave të njeriut.⁴⁰ Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se kundërshtimet ndaj ligjshmërisë së DHS-së nuk përbëjnë kundërshtime juridiksionale në kuptimin e rregullës 97(1)(a) të Rregullores dhe mund të hidhen poshtë edhe vetëm për këtë arsye.⁴¹ ZPS-ja gjithashtu pretendon se parashtrimet e z. Selimi mbi praktikën e punësimit të DHS-së duhet të hidhen poshtë menjëherë, pasi nuk është e qartë se mbi çfarë baze bëhet kjo kërkesë dhe/ose cilët janë personat të drejtat e të cilëve po shkelen.⁴² Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se kërkesa e z. Selimi për mbajtjen e një seance gojore duhet të refuzohet pasi ai ka pasur mundësi të mjaftueshme për të parashtruar argumentet e tij me shkrim.⁴³

13. Z. Thaçi kundërpërgjigjet duke parashtruar se ZPS-ja shpërfill Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, Ligji nr. 04/L-123 ("KPPK") kur vlerëson afatin ligjor për përmbylljen e hetimit penal.⁴⁴ Sa i përket mandatit kohor të DHS-së, z. Thaçi pretendon se jurisprudenca e DHSGJK-së në të cilën mbështetet ZPS-ja nuk është asgjë më shumë se *obiter dicta* dhe për rrjedhim Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të bëjë konstatime në lidhje me këtë çështje ose t'ia referojë DHSGJK-së çështjen e mandatit kohor të DHS-së.⁴⁵

14. Për sa i përket pretendimit të ZPS-së për papranueshmëri, z. Thaçi kundërpërgjigjet se qëndrimi i ZPS-së nuk është në përputhje me nenin 6(1) të KEDNJ-së.⁴⁶ Gjithashtu, z. Thaçi kundërpërgjigjet se, në kohën kur është nxjerrë aktgjykimi i

³⁹ Përgjigjja e ZPS-së F260, para. 1, 44.

⁴⁰ Përgjigjja e ZPS-së F260, para. 26-28.

⁴¹ Përgjigjja e ZPS-së F260, para. 2.

⁴² Përgjigjja e ZPS-së F260, para. 23-24.

⁴³ Përgjigjja e ZPS-së F260, para. 43.

⁴⁴ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F259, para. 23-28.

⁴⁵ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F259, para. 29.

⁴⁶ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 1.

GJKK-së, Ligji nuk mund të merrej në shqyrtim,⁴⁷ GJKK-ja dha përkufizimin “gjykatë e jashtëzakonshme” duke mos u bazuar në asnjë burim ligjor,⁴⁸ dhe ZPS-ja e ka keqinterpretuar jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (“GJEDNJ”) në lidhje me të drejtën për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj.⁴⁹ Z. Thaçi më tej argumenton se largimi nga detyra i Prokurorit të Specializuar të mëparshëm ishte në kundërshtim me nenin 35(5) të Ligjit.⁵⁰ Gjithashtu, z. Thaçi kundërpërgjigjet se Raporti 12462 i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës i 7 janarit 2011 (“Raporti i KE-së”) nuk mund të trajtohet i izoluar dhe mbështetja e tij nga DHS-ja dhe përfaqësuesit e saj shkel të drejtën e tij për t’u konsideruar i pafajshëm.⁵¹ Z. Thaçi argumenton se standardi i “ndikimit juridik”, që ka të bëjë me të drejtën për t’u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme, përfshin ngjarje që kanë ndodhur para ngritjes së akuzave dhe madje edhe para fillimit të hetimit zyrtar.⁵² Z. Thaçi më tej parashtrohet se ZPS-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj për të dhënë shpjegime lidhur me kohëzgjatjen e procesit dhe për rrjedhim kjo çon në supozimin se me kalimin e afatit është shkelur standardi i nenit 6(1) të KEDNJ-së.⁵³

15. Z. Selimi kundërpërgjigjet duke parashtuar se argumentet e tij në lidhje me praktikën e punësimit të DHS-së lidhen drejtpërdrejt me çështjen nëse DHS-ja është një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj.⁵⁴ Z. Selimi më tej kundërpërgjigjet se pretendimet e tij nuk ngrihen në emër të shqiptarëve të Kosovës, por më tepër kanë të bëjnë me të drejtat e tij personale.⁵⁵ Z. Selimi parashtrohet se praktikën e punësimit të DHS-së shkelin legjislacionin e Kosovës si dhe nenet 6 dhe 14

⁴⁷ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 2.

⁴⁸ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 3.

⁴⁹ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 4-6.

⁵⁰ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 11-15.

⁵¹ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 16-20.

⁵² Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 21-25.

⁵³ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 26-28.

⁵⁴ Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 3-10.

⁵⁵ Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 11.

të KEDNJ-së⁵⁶ dhe se mungesa e gjykatësve dhe personelit nga Kosova përbën një shkelje themelore që komprometon drejtësinë e procesit.⁵⁷ Z. Selimi përsërit kërkesën e tij për mbajtjen e një seance gojore dhe për hedhjen poshtë të Aktakuzës së Konfirmuar.⁵⁸

16. Z. Veseli kundërpërgjigjet duke parashtruar se kundërshtimi i ngritur ndaj ligjshmërisë së DHS-së nënkupton domosdoshmërisht edhe mosnjohjen e juridiksionit të gjykatës dhe është brenda përcaktimit të rregullës 97(1)(a) të Rregullores, e cila nuk jep ndonjë përkufizim se çfarë nënkuptohet me mosnjohje të juridiksionit.⁵⁹ Z. Veseli gjithsesi ia lë Gjykatësit të Procedurës Paraprake të vendosë nëse do t'i shqyrtojë parashtrimet e tij të dorëzuara në bazë të rregullës 75 apo rregullës 97(1)(a) të Rregullores.⁶⁰ Gjithsesi, DHSGJK-ja duhet të shqyrtojë kushtetutshmërinë e Ligjit.⁶¹ Z. Veseli pretendon se DHS-ja është *de facto* një gjykatë e jashtëzakonshme siç ilustruhet nga kriteret e Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit ("Komisioni i Venecias") dhe se krahasimet që ZPS-ja bën me gjykatat e tjera ndërkombëtare janë të papërshtatshme.⁶²

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. MOCIONET PARAPRAKE

17. Sipas nenit 39(1) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetencë për ta shqyrtuar aktakuzën, për të vendosur lidhur me mocionet paraprake, duke përfshirë kundërshtimin e aktakuzës dhe të juridiksionit, si dhe për të nxjerrë çdo urdhër apo

⁵⁶ Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 12-29.

⁵⁷ Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 29-30.

⁵⁸ Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 1, 31.

⁵⁹ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 2.

⁶⁰ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 3-4.

⁶¹ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 5-14, 21.

⁶² Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 15-20.

vendim të nevojshëm, për të siguruar që çështja gjyqësore të përgatitet si duhet dhe në mënyrë të shpejtë për gjykim.

18. Sipas rregullës 97(1) të Rregullores, i akuzuari mund t'i paraqesë mocione paraprase Gjykatësit të Procedurës Paraprase, në përputhje me nenin 39(1) të Ligjit, të cilat: (a) ngrenë kundërshtime ndaj juridiksionit të Dhomave të Specializuara; (b) pretendojnë mangësi në formën e aktakuzës, dhe (c) kërkojnë veçimin e akuzave.

B. MANDATI KOHOR I DHS-SË

19. Sipas nenit 116(1) të Kushtetutës, vendimet e GJKK-së janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Kosovës.

20. Sipas nenit 162(13) të Kushtetutës, mandati i Dhomave të Specializuara do të zgjasë për një periudhë pesëvjeçare (5), përveç nëse njoftimi i përfundimit të mandatit në pajtim me Ligjin nr. 04/L-274 bëhet më herët.

21. Sipas nenit 162(14) të Kushtetutës, në mungesë të njoftimit për përfundim të mandatit sipas paragrafit 12, mandati i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar do të vazhdojë deri kur njoftimi i përfundimit të mandatit të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 04/L-274 dhe në konsultim me qeverinë.

22. Sipas nenit 49(1) të Ligjit, DHSGJK-ja është autoriteti më i lartë për interpretimin e Kushtetutës në lidhje me juridiksionin lëndor dhe punën e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

C. LIGJSHMËRIA E HETIMIT TË ZPS-SË

23. Sipas nenit 3(2)(b) dhe (c) të Ligjit, Dhomat e Specializuara gjykojnë dhe funksionojnë në përputhje me, ndër të tjera, këtë Ligj si *lex specialis* dhe me dispozitat

e tjera të ligjeve të Kosovës të përfshira shprehimisht në këtë ligj dhe të zbatuara nga ky ligj.

24. Sipas nenit 3(4) të Ligjit, çdo ligj tjetër i Kosovës, rregullore, rregullore dytësore, rregull ose zakon tjetër dhe praktikë që nuk është përfshirë shprehimisht në këtë ligj, nuk zbatohet për organizimin, administrimin, funksionet apo juridiksionin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Ky ligj mbizotëron mbi çdo dispozitë kundërthënëse të çfarëdo ligji apo rregulloreje tjetër.

25. Sipas nenit 19(2) të Ligjit, Rregullat e Procedurës dhe Provave pasqyrojnë standardet më të larta të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, me synim garantimin e shqyrtimit gjyqësor të drejtë dhe të shpejtë, duke marrë parasysh llojin, vendin dhe specifikat e procedurës që shqyrtohet nga Dhomat e Specializuara. Në përcaktimin e Rregullave të Procedurës dhe Provave, Dhomat e Specializuara drejtohen nga Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.

26. Sipas rregullës 4 të Rregullores, Rregullorja interpretohet në pajtim me kornizën e përcaktuar në nenin 3 të Ligjit, dhe nëse është e përshtatshme, me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

27. Sipas rregullës 47(1) të Rregullores, në qoftë se Prokurori i Specializuar nuk paraqet aktakuzë kundër një personi para Dhomave të Specializuara sipas nenit 38(4) të Ligjit brenda një periudhe të arsyeshme pasi ky person të jetë bërë i dyshuar dhe të jetë informuar për këtë, i dyshuari mund t'i kërkojë Prokurorit të Specializuar pushimin e hetimit kundër tij ose saj.

D. E DREJTA PËR T'U GJYKUAR NGA NJË GJYKATË E THEMELUAR ME LIGJ

28. Sipas nenit 103(7) të Kushtetutës, gjykata të specializuara mund të themelohen me ligj kur kjo të jetë e nevojshme.

29. Sipas nenit 162(1) të Kushtetutës, për të përmbushur obligimet ndërkombëtare në lidhje me Raportin e Këshillit të Evropës, Kosova mund të themelojë Dhoma të Specializuara dhe Zyrë të Prokurorit të Specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë së Kosovës. Organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar rregullohen me këtë nen dhe me ligj të veçantë.

E. E DREJTA PËT T'U GJYKUAR NGA NJË GJYKATË E PAVARUR DHE E PAANSHME

30. Sipas nenit 162(10) të Kushtetutës, emërimi dhe mbikëqyrja e gjykatësve dhe prokurorëve, si dhe mbikëqyrja dhe administrimi i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar bëhet në pajtim me një ligj të veçantë.

31. Sipas nenit 25(3) të Ligjit, rregullat për caktimin e gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga regjistri i gjykatësve ndërkombëtarë ("Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve")⁶³ miratohen nga gjykatësit e Dhomave të Specializuara gjatë seancës plenare sa më shpejt të jetë e mundur pas emërimit të tyre dhe përfshirjes së tyre në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë ("Regjistri").

32. Sipas nenit 27(1) të Ligjit, gjykatësit e Dhomave të Specializuara janë persona me moral të lartë, paanshmëri dhe integritet. Ata janë të pavarur në përmbushjen e funksioneve të tyre dhe nuk pranojnë, as kërkojnë udhëzime nga ndonjë qeveri ose burim tjetër.

33. Sipas nenit 28 të Ligjit, një panel përzgjedhës i pavarur është përgjegjës për vlerësimin e kandidatëve dhe përzgjedhjen për emërimin e gjykatësve për Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë, si dhe rekomandimet për emërimin e Kryetarit dhe nënkryetarit të Dhomave të Specializuara ("Paneli Përzgjedhës"). Paneli Përzgjedhës

⁶³ KSC-LD-2017-02, *Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë* ("Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve"), 21 mars 2017, publike.

përbëhet nga tre anëtarë ndërkombëtarë, ku së paku dy anëtarë janë gjykatës ndërkombëtarë me përvojë të konsiderueshme ndërkombëtare në të drejtën penale ndërkombëtare. Pasi t'i ketë shqyrtuar kandidatët e kualifikuar, Paneli Përzgjedhës finalizon listën me emrat e kandidatëve që i rekomandon për pozitën e gjykatësit në Dhomat e Specializuara. Paneli Përzgjedhës ia paraqet këtë listë Shefit të Misionit të Bashkimit Evropian ("BE") për Politikë të Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes ("Autoriteti Emërues") si rekomandime për emërimin e gjykatësve të Dhomave të Specializuara në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë. Autoriteti Emërues i emëron personat nga lista e Panelit Përzgjedhës si gjykatës në Dhomat e Specializuara dhe i përfshin në Regjistër për aq kohë sa ekzistojnë Dhomat e Specializuara.

34. Sipas nenit 30(3) të Ligjit, kur një gjykatës nga Regjistri caktohet për të marrë pjesë në fazën e procedurës paraprake, gjykimit, apelit ose në fazën e gjykatës supreme të një çështjeje gjyqësore, ose kur caktohet për të marrë pjesë në shqyrtimin e ndonjë referimi kushtetues në DHSGJK, në pajtim me nenin 33 të Ligjit, ai gjykatës caktohet për një mandat katërvjeçar ose deri në përfundimin e fazës së procesit në të cilin është caktuar, në rast se ajo fazë përfundon më herët.

35. Sipas nenit 31(1) të Ligjit, gjykatësit e Dhomave të Specializuara janë të pavarur në kryerjen e funksioneve të tyre.

36. Sipas nenit 31(4) të Ligjit, asnjë gjykatës nuk mund të përjashtohet, përveç nëse gjykatësit e tjerë, me shumicë absolute, vërtetojnë se ai ose ajo nuk i plotëson më kushtet e parapara në nenet 27 dhe 31 të Ligjit.

37. Sipas nenit 32(1) dhe (4) të Ligjit, bazuar në rekomandimin e Panelit Përzgjedhës, Autoriteti Emërues emëron Kryetarin dhe nënkryetarin e Dhomave të Specializuara nga radhët e gjykatësve të DHS-së, të cilët shërbejnë me orar të plotë.

38. Sipas nenit 32(3) të Ligjit, Kryetari i Dhomave të Specializuara është përgjegjës për administrimin gjyqësor të DHS-së dhe për funksionet e tjera që i ngarkohen me këtë ligj.

39. Sipas nenit 33(1) të Ligjit, Kryetari i Dhomave të Specializuara cakton gjykatësit nga Regjistri në përputhje me Rregulloren për caktimin e gjykatësve të DHS-së.

40. Sipas nenit 33(4) të Ligjit, kur një gjykatës caktohet si Gjykatës i Procedurës Paraprake apo si anëtar i ndonjë paneli për ndonjë çështje, ai gjykatës nuk mund të jetë anëtar i ndonjë paneli tjetër në një fazë tjetër të së njëjtës çështjeje.

41. Sipas nenit 63(1) të Ligjit, Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar kanë buxhetin e tyre, që nuk vjen nga buxheti i Kosovës.

42. Sipas rregullës 21(2) të Rregullores, pas dorëheqjes ose vdekjes së një gjykatësi, ose njoftimit për rrethana shëndetësore që nuk i mundësojnë gjykatësit ose gjykatësve të paraqesë vetë dorëheqjen, Kryetari njofton Autoritetin Emërues në rast se numri i gjykatësve në Regjistrë është nën nivelin që mundëson funksionimin e duhur të Dhomave të Specializuara.

43. Sipas rregullës 22 të Rregullores, përjashtimi nga Regjistri në përputhje me nenin 31(4) të Ligjit, masat e tjera disiplinore, si edhe procedura përkatëse, rregullohen prej Kodit të Etikës Gjyqësore për Gjykatësit e Emëruar në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Kodi i Etikës Gjyqësore").⁶⁴

44. Sipas rregullës 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të DHS-së, caktimi i gjykatësve është një proces i paanshëm dhe transparent dhe garanton funksionimin efikas, efektiv dhe të shpejtë të Dhomave të Specializuara. Gjithashtu, rregulla 4(2) e Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të DHS-së parashikon që për caktimin e gjykatësve, Kryetari niset nga kritere objektive, si përvoja, kompetenca, përparësia në bazë të datës së emërimit ose të moshës dhe përfaqësimi gjinor ose gjeografik, si dhe nga parapëlqimet e gjykatësve dhe disponueshmëria e tyre. Rregulla 4(3) e Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të DHS-së përcakton që gjatë caktimit merret

⁶⁴ KSC-BD-01/COR2, *Kodi i Etikës Gjyqësore për Gjykatësit e Emëruar në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës*, 14 mars 2017, publik.

parasysh veprimtaria e mëhershme e gjykatësve që me gjasë vë në dyshim paanshmërinë e tyre apo ndikon në ndershmërinë e procesit.

45. Sipas nenit 18(2) dhe (3) të Kodit të Etikës Gjyqësore, Komisioni Disiplinor përbëhet nga tre anëtarë, ku të paktën dy prej tyre janë nga gjyqësori. Anëtari i tretë mund të jetë i emëruar i lartë i Bashkimit Evropian. Kryetarit nuk i lejohet të jetë anëtar i këtij Komisioni. Komisioni Disiplinor zgjedh kryesuesin e vet. Komisioni Disiplinor heton pretendimet e paraqitura në ankesën e përcjellë nga Kryetari.

46. Sipas nenit 21 të Kodit të Etikës Gjyqësore, kur gjykatësit konstatojnë se janë vërtetuar një apo më shumë pretendime sipas nenit 13 të Kodit të Etikës Gjyqësore, gjykatësit e mbledhur në seancë plenare, me shumicë absolute të gjykatësve të Regjistrit me të drejtë vote, marrin vendimin për përjashtimin e Gjykatësit Përgjigjës nga Regjistri, në përputhje me nenin 31(4) të Ligjit. Përjashtimi nga Regjistri hyn në fuqi menjëherë. Gjykatësi Përgjigjës pushon së qeni gjykatës i Dhomave të Specializuara, dhe i cilëso çështjeje të papërfunduar në të cilën është caktuar.

F. E DREJTA PËR TË MOS U GJYKUAR NGA NJË GJYKATË E JASHTËZAKONSHME

47. Sipas nenit 103(7) të Kushtetutës, asnjëherë nuk mund të themelohen gjykata të jashtëzakonshme.

G. E DREJTA PËR T'U KONSIDERUAR I PAFAJSHËM DHE PËR T'U GJYKUAR BRENDË NJË KOHE TË ARSYESHME

48. Sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 21 të Ligjit, gjithkush, në shqyrtimin e akuzave kundër tij ose saj, gëzon, ndër të tjera, të drejtën të konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij përtej dyshimit të arsyeshëm dhe të gjykohet brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj.

H. REFERIMET PËR DHOMËN E SPECIALIZUAR TË GJYKATËS KUSHTETUESE

49. Sipas nenit 49(4) të Ligjit, në pajtim me nenin 113(8) të Kushtetutës, një gjykatës i procedurës paraprake ose panel i Dhomave të Specializuara mund t'i drejtojnë pyetje Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese lidhur me kushtetutshmërinë e ndonjë ligji, kur gjykatësi ose paneli nuk janë të sigurtë për kushtetutshmërinë e ligjit të kundërshtuar dhe kur vendimi i tyre për atë çështje varet nga kushtetutshmëria e ligjit në fjalë.

50. Sipas rregullës 75(5) të Rregullores, palët dhe mbrojtësi i viktimave nuk kanë të drejtë të paraqesin mocion për referim sipas nenit 49(4) të Ligjit dhe mocionet e paraqitura për këtë qëllim nuk do të merren në shqyrtim. Kjo nuk e pengon panelin që të bëjë referim në përputhje me nenin 49(4) të Ligjit, e as të akuzuarin ose mbrojtësin e viktimave që të bëjnë referime në përputhje me nenin 49(3) të Ligjit.

IV. DISKUTIM

A. ÇËSHTJE PARAPRAKE

1. A janë kundërshtimet e ngritura nga Mbrojtja brenda fushëveprimit të rregullës 97(1)(a) të Rregullores

51. Para së gjithash, është e nevojshme të përcaktohet lloji i mocioneve që ka paraqitur Mbrojtja. Në kuadër të debateve të saj ligjore në lidhje me mocionet paraprake Mbrojtja ka ngritur disa pika kushtetuese, duke i lidhur ato shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar me kundërshtimin e juridiksionit. Sipas z. Thaçi, shkeljet e të drejtave të tij themelore kanë ndikuar në integritetin e procesit gjyqësor në një shkallë të tillë që përligj refuzimin për të ushtruar juridiksionin si e vetmja mënyrë për të

ndrequr shkeljet e kryera ndaj të akuzuarit.⁶⁵ Z. Selimi argumenton se për shkak të politikës diskriminuese të punësimit të DHS-së, Dhomat e Specializuara nuk kanë juridiksion të gjykojnë në lidhje me akuzat kundër tij dhe kërkon që Aktakuza të hidhet poshtë.⁶⁶ Z. Veseli ngre disa pika kushtetuese që lidhen me natyrën e DHS-së dhe dispozitat ligjore përkatëse dhe, megjithëse ngre kundërshtim ndaj juridiksionit të DHS-së, kërkon që kjo pikë t'i referohet DHSGJK-së.⁶⁷ ZPS-ja argumenton se kundërshtimet që lidhen me bazën ligjore ose me themelin e DHS-së nuk përbëjnë kundërshtim juridiksional brenda kuptimit të rregullës 97(1)(a) të Rregullores, dhe, për rrjedhojë, duhet të hidhen poshtë vetëm mbi këtë bazë.⁶⁸

52. Z. Thaçi kundërpërgjigjet se pretendimi për papranueshmëri i ZPS-së nuk është i pajtueshëm me faktin se fraza “themeluar me ligj” ose kriteret e pavarësisë gjyqësore të përcaktuara në nenin 6(1) të KEDNJ-së duhet të përmbushen në çdo shkallë gjyqësore dhe se rregulla 97(1)(a) e Rregullores nuk mund t'i heqë atij të drejtën themelore për të përdorur mjete juridike efektive.⁶⁹

53. Z. Veseli kundërpërgjigjet se kundërshtimi i ligjshmërisë së DHS-së është i barasvlershëm me mosnjohjen e juridiksionit të saj përderisa rregulla 97(1)(a) e Rregullores nuk jep ndonjë përkufizim të asaj se çfarë nënkuptohet me mosnjohje të juridiksionit.⁷⁰

54. Neni 39(1) i Ligjit përcakton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetencë për të vendosur lidhur me *çdo* mocion paraprak, duke përfshirë por pa u kufizuar me kundërshtimet lidhur me aktakuzën dhe juridiksionin. Rregulla 97(1) dhe (3) e Rregullores saktëson më tej sistemin që zbatohet për mocionet paraprake më të

⁶⁵ Mocioni i Thaçit, para. 53-54.

⁶⁶ Mocioni i Selimit, para. 2-3, 20(a) dhe (b).

⁶⁷ Mocioni i Veselit, para. 1, 21. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, Transkripti, 21 korrik 2021, publik, f. 520, rreshtat 6-15.

⁶⁸ Përgjigjja e ZPS-së F260, para. 2.

⁶⁹ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 1.

⁷⁰ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 2.

zakonshme, konkretisht për të dalluar mocionet paraprake ku apeli lejohet vetvetiu (p.sh. ato që ngrenë kundërshtime ndaj juridiksionit të DHS-së) nga ato për të cilat kërkohet leje para se të miratohet apeli. Rregulla 97(1)(a) e Rregullores nuk i përkufizon kundërshtimet juridiksionale. Megjithatë, nenet 6 deri 9 të Ligjit përcaktojnë kategoritë tradicionale të juridiksionit: juridiksionin lëndor, kohor, territorial dhe personal.⁷¹ Kundërshtimet që lidhen me ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së ose me shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të të akuzuarve nuk përfshihen në këto katër kategori tradicionale të juridiksionit. Megjithëse në disa raste është konstatuar se kundërshtimi juridiksional mund të përfshijë aspekte më të gjera të ligjshmërisë së një institucioni,⁷² në raste të tjera juridiksioni është përcaktuar në një mënyrë shumë më të ngushtë.⁷³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se kundërshtimet e të akuzuarve nuk arrijnë të jenë kundërshtime juridiksionale, pasi ato nuk përfshihen në përcaktimin e qartë që ofrojnë nenet 6 deri 9 të Ligjit dhe, rrjedhimisht, nuk përbëjnë kundërshtime juridiksionale .

55. Sidoqoftë, edhe pse Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk do t'i trajtojë kundërshtimet e lartpërmendura në kuadër të rregullës 97(1)(a) të Rregullores, ai do

⁷¹ Shih gjithashtu Vendimi i Konfirmimit, para. 31.

⁷² ICTY, *Prosecutor v. Tadic*, IT-94-1, Appeals Chamber, [Decision On The Defence Motion For Interlocutory Appeal On Jurisdiction](#), 2 October 1995, para. 6; ICTR, *Prosecutor v. Kanyabashi*, ICTR-96-15-T, Trial Chamber, [Decision on the Defence Motion on Jurisdiction](#), 18 June 1997, para. 6.

⁷³ Vërejmë se koncepti i juridiksionit të TPNJ-së dhe TPNR-së u përcaktua në një mënyrë më të hollësishme pas një ndryshimi që iu bë Rregullores, i cili dha përcaktimin e mosnjohjes së juridiksionit. ICTR, *Nzitorera v. The Prosecutor*, ICTR-98-44-AR72, Appeals Chamber, [Decision Pursuant to Rule 72\(E\) of the Rules of Procedure and Evidence on Validity of Appeal of Joseph Nzitorera Regarding Chapter VII of the Charter of the United Nations](#), 10 June 2004, para. 9-10; ICTY, *Prosecutor v. Tolimir*, Appeals Chamber, IT-05-88/2-AR72.2, [Decision on Zdravko Tolimir's Appeal Against the Decision on Submissions of the Accused Concerning Legality of Arrest](#), 12 March 2009, publik, para. 11-12; *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Decision on the Accused's Motion Challenging the Legal Validity and Legitimacy of the Tribunal](#), 7 December 2009, publik, para. 8; STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/FT/AC/AR90.1, Appeals Chamber, [Decision on the Defence Appeals Against the Trial Chamber's "Decision on the Defence Challenges to the Jurisdiction and Legality of the Tribunal"](#), 24 October 2012, para. 18. Në lidhje me shkeljet e të drejtave që dalin jashtë kuadrit të mosnjohjes së juridiksionit shih ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-722, Appeals Chamber, [Judgment on the Appeal of Mr. Thomas Lubanga Dyilo against the Decision Defence Challenge to the Jurisdiction of the Court Pursuant to Article 19\(2\)\(a\) of the Statute of 3 October 2006 \("Lubanga Appeal on Jurisdiction"\)](#), 14 December 2006, publik, para. 21-22, 24.

t'i trajtojë kundërshtimet e parashtruara nga palët në përputhje me kompetencën e tij sipas nenit 39(1) të Ligjit.

56. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kundërshtimet e ngritura nga ana e z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi lidhur me ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së, apo pretendimet për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese, janë të pranueshme.

2. Kërkesa për seancë publike

57. Z. Selimi kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të caktojë mbajtjen e një seance gojore në mënyrë që t'i japë Mbrojtjes mundësinë për t'u dëgjuar.⁷⁴ ZPS-ja përgjigjet se kërkesa e z. Selimi është krejtësisht e pabazë dhe si e tillë duhet të hidhet poshtë.⁷⁵

58. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, ndërsa brenda kornizës ligjore të DHS-së disa seanca që mbahen për çështje të caktuara janë rreptësisht të domosdoshme, për shembull, seancat e paraqitjeve të para të të dyshuarve dhe konferencat mbi ecurinë e çështjes gjyqësore që kanë të bëjnë me nxjerrjen e provave,⁷⁶ në raste të tjera mbajtja e seancës bëhet mbi bazën e ushtrimit të kompetencës diskrecionale.⁷⁷

59. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se z. Selimi nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje konkrete në mbështetje të kërkesës së tij për mbajtjen e një seance gojore. Duke pasur parasysh parashtrimet e shumta dhe shteruese të paraqitura me

⁷⁴ Mocioni i Selimit, para. 20(c); Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 31(c).

⁷⁵ Përgjigjja e ZPS-së F260, para. 43.

⁷⁶ Neni 41(5) i Ligjit; Rregulla 92 e Rregullores (paraqitjet e para); Rregulla 96 e Rregullores (konferencat mbi ecurinë e çështjes gjyqësore).

⁷⁷ Rregulla 95(2)(d) e Rregullores. KSC-BC-2020-06, F00178, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, publik, para. 62; F00150, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kryerjen e Rishikimit të Paraburgimit dhe Ndryshimin e Afatit për Mocionet Paraprake*, 16 dhjetor 2020, publik, para. 18.

shkrim nga palët, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se mbajtja e një seance gojore nuk është e nevojshme.

60. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hedh poshtë kërkesën e z. Selimi për mbajtjen e seancës gojore.

B. KUNDËRSHTIMET LIDHUR ME LIGJSHMËRINË E DHS-SË DHE ZPS-SË

1. Mandati kohor i DHS-së

61. Z. Thaçi parashtron se, në bazë të nenit 162(13) të Kushtetutës, mandati maksimal kohor i DHS-së dhe ZPS-së ka mbaruar më 3 gusht 2020, pesë vjet pas miratimit të Amendamentit nr. 24 të Kushtetutës nga Kuvendi i Kosovës, me anë të të cilit u paraqit neni 162 i saj.⁷⁸ Si rezultat, e gjithë puna e kryer nga DHS-ja dhe ZPS-ja pas kësaj date, duke përfshirë edhe nxjerrjen e Aktakuzës së Konfirmuar, është jokushtetuese.⁷⁹

62. Gjithashtu, z. Thaçi rikujton se kohët e fundit DHSGJK-ja konstatoi se amendamenti i propozuar në gusht 2020 pakësonte të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës pasi nuk i referohej Shkëmbimit të Letrave.⁸⁰ Z. Thaçi argumenton se nëse ka mospërputhje midis Shkëmbimit të Letrave dhe Kushtetutës, ajo që duhet të mbizotërojë është Kushtetuta.⁸¹ Ai kundërshton interpretimin sipas të cilit neni 162(14) i Kushtetutës, parashikon një mandat të pakufizuar dhe të vazhdueshëm për DHS-në, në mungesë të njoftimit për përfundimin e tij.⁸² Z. Thaçi

⁷⁸ Mocioni i Thaçit mbi Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së, para. 44-45.

⁷⁹ Mocioni i Thaçit mbi Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së, para. 46.

⁸⁰ Mocioni i Thaçit mbi Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së, para. 47, që i referohet KSC-CC-2020-11, F00015, DHSGJK, *Aktgjykim mbi Referimin e Amendamenteve të Propozuara të Kushtetutës së Kosovës* ("Aktgjykimi mbi Referimin"), 26 nëntor 2020, publik, para. 69. Shkëmbimi i letrave ndërmjet Presidentes së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të BE-së i kryer në vitin 2014 u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës. *Shih* Ligji nr. 04/L-274 për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, 23 prill 2014. Këtyre letrave do t'u referohemi bashkërisht si "Shkëmbimi i Letrave".

⁸¹ Mocioni i Thaçit mbi Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së, para. 48.

⁸² Mocioni i Thaçit mbi Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së, para. 49.

parashtron se njoftimi, të cilit i referohet neni 162(14) i Kushtetutës, ka të bëjë vetëm me mandatin minimal kohor, ndërsa mandati maksimal kohor i DHS-së është përcaktuar në nenin 162(13) të Kushtetutës.⁸³ Së fundi, z. Thaçi argumenton se DHS-ja ka të drejtë të rishikojë mandatin e saj kohor dhe duhet ta bëjë këtë për të respektuar të drejtën e tij për t'u gjykuar nga një gjykatë e themeluar me ligj.⁸⁴

63. ZPS-ja përgjigjet se z. Thaçi shpërfill konstatimet detyruese të DHSGJK-së, që kanë përcaktuar se mandati i DHS-së nuk është i kufizuar vetëm në pesë vjet dhe do të vazhdojë deri kur Këshilli i BE-së të njoftojë Kosovën për përfundimin e tij.⁸⁵ Gjithashtu, ZPS-ja i referohet formulimit të Shkëmbimit të Letrave, që saktëson se mandati i DHS-së do të vazhdojë deri në përfundimin e proceseve gjyqësore.⁸⁶ ZPS-ja parashtron se ishte pikërisht amendamenti i propozuar nga Presidenti i atëhershëm Thaçi që do të kishte hequr garancitë e rëndësishme që kishin të bënin me vazhdimin e funksionimit të DHS-së në mënyrë "të sigurt, të pavarur, të paanshme, të drejtë dhe efikase".⁸⁷

64. Z. Thaçi kundërpërgjigjet se arsyetimi i DHSGJK-së në të cilin mbështetet ZPS-ja është thjesht *obiter dictum*.⁸⁸ Në mbështetje të pikëpamjes së tij, z. Thaçi thekson faktin se dispozitivi i aktgjykimit të DHSGJK-së nuk e trajtonte këtë aspekt dhe, në përputhje me nenin 144(3) të Kushtetutës, trajtonte vetëm aspektin nëse ishte cenuar ndonjë nga të drejtat ose liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.⁸⁹ Rrjedhimisht, z. Thaçi konsideron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të shqyrtojë përfundimin e mandatit të DHS-së ose t'ia referojë këtë çështje DHSGJK-së.⁹⁰

⁸³ Mocioni i Thaçit mbi Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së, para. 50-51.

⁸⁴ Mocioni i Thaçit mbi Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së, para. 51-52.

⁸⁵ Përgjigja e ZPS-së, F259, para. 30.

⁸⁶ Përgjigja e ZPS-së, F259, para. 31.

⁸⁷ Përgjigja e ZPS-së, F259, para. 32.

⁸⁸ Kundërpërgjigja e Thaçit ndaj F259, para. 29.

⁸⁹ Kundërpërgjigja e Thaçit ndaj F259, para. 29.

⁹⁰ Kundërpërgjigja e Thaçit ndaj F259, para. 30.

65. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se DHSGJK-ja, duke iu referuar argumentit të Presidentit të atëhershëm Thaçi se kishte paqartësi në formulimin e neneve 162(13) dhe (14) të Kushtetutës, që mund të nënkuptonte se kohëzgjatja e mandatit të DHS-së ishte e kufizuar për një periudhë pesëvjeçare, deklaroi se “ nuk mund të gjejë një interpretim të tillë të këtyre dispozitave”.⁹¹ DHSGJK-ja më tej përcaktoi në mënyrë të qartë se neni 162(13) dhe (14) i Kushtetutës parashikon se në rast se nuk ka njoftim për përfundimin e mandatit, mandati i DHS-së vazhdon pas periudhës fillestare pesëvjeçare deri në marrjen e njoftimit për përfundimin e tij.⁹² Gjithashtu, DHSGJK-ja përcaktoi se vazhdimi i mandatit të DHS-së dhe ZPS-së ishte në pajtim me Shkëmbimin e Letrave, që saktëson se mandati i DHS-së vazhdon deri në momentin kur Kosova merr njoftim nga Këshilli i BE-së se hetimet dhe proceset gjyqësore si rezultat i atyre hetimeve kanë përfunduar.⁹³

66. Ndërsa Presidenti i atëhershëm Thaçi i referohej “paqartësisë” në lidhje me kohëzgjatjen e mandatit të DHS-së si arsye për paraqitjen e amendamenteve të propozuara prej tij në paragrafët 13 dhe 14 të nenit 162 të Kushtetutës,⁹⁴ vlerësimi i DHSGJK-së për mandatin e DHS-së nuk mund të konsiderohet *obiter dictum*, por një hap vendimtar në përcaktimin e pasojave të amendamenteve të propozuara nga z. Thaçi dhe të çështjes nëse këto amendamente pakësonin të drejtat dhe liritë themelore të personave të përfshirë në procese gjyqësore.⁹⁵ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se DHSGJK-ja trajtoi gabimin teknik në nenin 162(14) të Kushtetutës, i cili i referohet gabimisht paragrafit 12 në vend që t’i referohet paragrafit 13.⁹⁶

⁹¹ Aktgjykimi mbi Referimin, para. 65.

⁹² Aktgjykimi mbi Referimin, para. 66.

⁹³ Aktgjykimi mbi Referimin, para. 67.

⁹⁴ Aktgjykimi mbi Referimin, para. 41-42, 65-67.

⁹⁵ Aktgjykimi mbi Referimin, para. 68-69.

⁹⁶ Aktgjykimi mbi Referimin, para. 70.

67. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, sipas nenit 116(1) të Kushtetutës dhe nenit 49(1) të Ligjit, vendimet e DHSGJK-së janë detyruese, pavarësisht se cilave pjesë të aktgjykimeve u referohen. Meqë DHSGJK-ja shtjelloi me hollësi aspektin e mandatit kohor të DHS-së, fakti që përfundimet e nxjerra prej saj nuk u përsëritën në pjesën vendimore të aktgjykimit përkatës nuk shkakton ndonjë pasojë ligjore. Si rrjedhim, Gjykatësi i Procedurës gjykon se nuk ka asnjë arsye për rivlerësimin e çështjeve për të cilat tashmë është marrë vendimi nga DHSGJK-ja.

68. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hedh poshtë kundërshtimet në lidhje me mandatin kohor të DHS-së.

2. Ligjshmëria e hetimit të ZPS-së

69. Z. Thaçi parashtron se hetimit të ndërmarrë nga ZPS-ja mbi bazën e Raportit të Këshillit të Evropës i mungon baza ligjore ose kushtetuese, pasi neni 1(2) i Ligjit e ndalon ZPS-në të kryejë hetime të reja.⁹⁷ Më konkretisht, z. Thaçi argumenton se, përderisa as Ligji dhe as Rregullorja nuk përcaktojnë periudhën brenda së cilës mund të kryhet hetimi, në bazë të një leximi të kombinuar të neneve 3(2)(c) dhe 19(2) të Ligjit dhe rregullës 4 të Rregullores, duhet të zbatohen afatet e përcaktuara në KPPK.⁹⁸ Neni 159 i KPPK-së përcakton që hetimi duhet të përfundojë brenda dy vjetësh dhe se hetimi duhet të pushohet menjëherë nëse brenda kësaj periudhe nuk është ngritur aktakuzë ose nuk është pezulluar hetimi.⁹⁹ Në këtë kuadër, z. Thaçi parashtron se TFHS-ja i filloi hetimet në lidhje me Raportin e Këshillit të Evropës në vitin 2011 dhe, në atë kohë, kryerja e tyre bazohej në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.¹⁰⁰ Z. Thaçi argumenton se, megjithëse në vitin 2014 TFHS-ja deklaroi se kishte prova të

⁹⁷ Mocioni i Thaçit mbi Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së, para. 53.

⁹⁸ Mocioni i Thaçit mbi Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së, para. 54-55.

⁹⁹ Mocioni i Thaçit mbi Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së, para. 55.

¹⁰⁰ Mocioni i Thaçit mbi Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së, para. 56.

mjaftueshme që mbështesnin ngritjen e një aktakuze,¹⁰¹ kjo e fundit u ngrit vetëm në vitin 2020, nëntë vjet pas fillimit të hetimit.¹⁰² Rrjedhimisht, z. Thaçi parashtron se aktakuza nuk u dorëzua brenda afatit dyvjeçar të përcaktuar në KPPK dhe se, për rrjedhojë, hetimi “i ri” i ZPS-së duhet të shpallet i paligjshëm dhe akuzat e bazuara në të, të hidhen poshtë.¹⁰³

70. ZPS-ja përgjigjet se mbështetja e z. Thaçi në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës është e pavend, përderisa neni 3 i Ligjit përcakton se dispozitat e ligjeve të Kosovës që nuk janë përfshirë shprehimisht dhe miratuar në këtë Ligj, nuk zbatohen.¹⁰⁴ ZPS-ja argumenton se, megjithëse gjykatësit e DHS-së u bazuan në dispozitat e KPPK-së kur miratuan Rregulloren, neni 159 i KPPK-së nuk u përfshi në Rregullore.¹⁰⁵ Përkundrazi, rregulla 47 e Rregullores parashikon që hetimi duhet të përfundojë brenda një “periudhe të arsyeshme” pasi personi të jetë bërë i dyshuar dhe të jetë njoftuar për këtë, dhe u konstatua se ky sistem ishte në përputhje të plotë me KEDNJ-në për sa i përket pushimit të hetimit.¹⁰⁶

71. ZPS-ja më tej thekson se i janë dhënë kompetenca të gjera hetimore dhe të ndjekjes penale prej Ligjit dhe Rregullores, gjë që bie në kundërshtim të plotë me idenë se koha për të hetuar çështjet e hetuara tashmë nga TFHS-ja ka mbaruar.¹⁰⁷ ZPS-ja argumenton se, nëse do të kishte filluar një hetim “të ri” lidhur me Raportin e Këshillit të Evropës, neni 159 i KPPK-së gjithsesi nuk do të ishte shkelur, pasi një hetim i tillë do të ishte “krejtësisht i ri”.¹⁰⁸

72. Z. Thaçi kundërpërgjigjet se në kohën e kryerjes së hetimit të TFHS-së, KPPK-ja ishte instrumenti i vetëm ligjor që rregullonte hetimet penale; si rrjedhim, Rregullorja

¹⁰¹ Mocioni i Thaçit mbi Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së, para. 57.

¹⁰² Mocioni i Thaçit mbi Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së, para. 58.

¹⁰³ Mocioni i Thaçit mbi Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së, para. 59.

¹⁰⁴ Përgjigjja e ZPS-së, F259, para. 23-24.

¹⁰⁵ Përgjigjja e ZPS-së, F259, para. 24-25.

¹⁰⁶ Përgjigjja e ZPS-së, F259, para. 25.

¹⁰⁷ Përgjigjja e ZPS-së, F259, para. 28.

¹⁰⁸ Përgjigjja e ZPS-së, F259, para. 29.

duhet interpretuar *a fortiori* në një mënyrë që përputhet me KPPK-në.¹⁰⁹ Z. Thaçi rikujton se, ndonëse neni 104 i KPPK-së parasheh që hetimi ka të përcaktuar datën dhe kohën e fillimit të tij me qëllim që gjykata të vlerësojë përputhshmërinë e tij me nenin 159 të KPPK-së, Ligji dhe Rregullorja nuk shprehen për procedurën me anë të së cilës fillohet hetimi dhe për kohëzgjatjen e tij maksimale.¹¹⁰ Rrjedhimisht, përmendja nga ZPS-ja e Rregullores që respekton standardet e KEDNJ-së është e pavend.¹¹¹ Së fundi, z. Thaçi përsërit se ZPS-ja nuk kishte autoritet ligjor për të kryer një hetim krejtësisht të ri pasi për këtë tashmë kishte kaluar afati.¹¹²

73. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton që në fillim se neni 3(2)(b)-(c) dhe (4) i Ligjit përcakton në mënyrë të qartë se Dhomat e Specializuara gjykojnë dhe funksionojnë, ndër të tjera, në përputhje me këtë Ligj si *lex specialis* dhe zbatojnë dispozitat e tjera të legjislacionit të Kosovës nëse ato janë të përfshira shprehimisht në Ligj dhe të zbatuara në bazë të tij. Sipas rregullës 4(1) të Rregullores, Rregullorja interpretohet në pajtim me kornizën e përcaktuar në nenin 3 të Ligjit. Në këtë kuadër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se neni 159(1) i KPPK-së, në të cilin bazohet z. Thaçi kur pretendon se hetimit të udhëhequr nga ZPS-ja i ka kaluar afati, nuk është përfshirë shprehimisht në Ligj ose në Rregullore.¹¹³

74. Ndonëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se neni 19(2) i Ligjit parasheh që, në përcaktimin e Rregullores së Procedurës dhe Provave, Dhomat e Specializuara drejtohen nga Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, ai nuk bindet nga argumenti i z. Thaçi se një dispozitë e tillë, e lexuar së bashku me nenin 3 të Ligjit dhe rregullën 4 të Rregullores, sugjeron që duhet të zbatohen dispozitat e përcaktuara në KPPK, duke përfshirë nenin 159(1). Në veçanti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se neni

¹⁰⁹ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F259, para. 23-24.

¹¹⁰ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F259, para. 24-26.

¹¹¹ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F259, para. 26.

¹¹² Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F259, para. 27.

¹¹³ *Shih, për ngjashmëri*, KSC-BC-2018-01, F00180/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Nxjerrjen e një Urdhri drejtuar Prokurorit të Specializuar për Pushimin e Hetimit kundër Driton Lajçit* ("Vendimi në lidhje me Hetimin kundër z. Lajçi"), 23 korrik 2021, publik, para. 16.

19(2) i Ligjit nuk kërkon detyrimisht përfshirjen e të njëjtave standarde të KPPK-së në Ligj, pasi një detyrim i tillë do të duhej të përcaktohej shprehimisht. Sipas Gjykatësit të Procedurës Paraprake, fjala “drejtohen” nënkupton që ndërsa gjykatësit duhet të mbajnë parasysh dispozitat e KPPK-së gjatë miratimit të Rregullores, dispozitat konkrete që përmban Kodi nuk kanë fuqi detyruese mbi ta.¹¹⁴ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se neni 159 i KPPK-së nuk mund të zbatohet në këtë rast dhe se për hetimet e kryera nga ZPS-ja nuk zbatohet afati dyvjeçar.

75. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Rregullorja parashikon një procedurë për shqyrtimin e ankesave në lidhje me tejzgjatjen e hetimeve. Në veçanti, rregulla 47(1) e Rregullores përcakton se pasi një person të jetë bërë i dyshuar dhe të jetë njoftuar për këtë, i dyshuari mund të ankohet për tejzgjatjen e pretenduar të hetimit duke i kërkuar ZPS-së pushimin e hetimit kundër tij ose saj. Ndonëse Rregullorja nuk përcakton një afat të caktuar për kohëzgjatjen maksimale të hetimit, nënkuptohet që vlerësimi i arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së hetimit do të bëhet rast pas rasti.¹¹⁵ Si rrjedhim, rregulla 47 e Rregullores përcakton standardin sipas të cilit do të duhet të shqyrtohet ankesa e z. Thaçi lidhur me kohëzgjatjen e hetimit, nëse bëhet një kërkesë e tillë. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se DHSGJK-ja la në fuqi rregullën 47 të Rregullores dhe konstatoi se ajo ishte në përputhje me Kushtetutën.¹¹⁶

76. Më përgjithësisht, lidhur me argumentin e z. Thaçi se ZPS-ja nuk ishte e autorizuar të kryente hetime ose të ngrinte aktakuza për çështje që tashmë ishin hetuar nga TFHS-ja, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se neni 35(2) i Ligjit përcakton që ZPS-ja, ka autoritetin dhe përgjegjësinë, ndër të tjera, për kryerjen e

¹¹⁴ *Shih, për ngjashmëri, Vendimi në lidhje me Hetimin kundër z. Lajçi, para. 17.*

¹¹⁵ *Shih, për ngjashmëri, Vendimi në lidhje me Hetimin e kundër z. Lajçi, para. 27-28.*

¹¹⁶ KSC-CC-PR-2017-01, F00004, DHSGJK, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Proovave Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas Nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Aktvendimi mbi Referimin e Rregullores Miratuar më 17 mars 2017”), 26 prill 2017, publik, para. 107.*

hetimeve penale dhe marrjen e përgjegjësisë për hetime penale të reja apo ekzistuese në kuadër të juridiksionit lëndor të Dhomave të Specializuara. Bazuar në formulimin konkret të nenit 35(2) të Ligjit, kjo nënkupton që ZPS-ja nuk mund të ndalohet të kryejë hetime të reja ose të vijojë hetime ekzistuese për fakte të tilla si ato që mbështesin akuzat kundër z. Thaçi, edhe nëse TFHS-ja ka kryer tashmë hetime lidhur me fakte të ngjashme, me kusht që të respektohen dispozitat e përcaktuara në Ligj dhe Rregullore që mbrojnë të drejtat e të akuzuarve për një gjykim të drejtë, sikurse është rregulla 47 e Rregullores. Çdo interpretim tjetër do ta bënte të pakuptimtë formulimin e nenit 35(2) të Ligjit.

77. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hedh poshtë argumentet e z. Thaçi lidhur me ligjshmërinë e hetimit.

C. SHKELJET E PRETENDUARA TË TË DREJTAVE KUSHTETUESE

78. Të akuzuarit pretendojnë se u janë shkelur disa të drejta kushtetuese, konkretisht e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj, e drejta për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme dhe e drejta për t'u konsideruar i pafajshëm. Neni 162(2) i Kushtetutës përcakton se Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar garantojnë të drejtat që përmban Kapitulli II i Kushtetutës dhe në veçanti veprojnë në pajtim me standardet për të drejtat e njeriut. Sipas nenit 55 të Kushtetutës dhe nenit 2 të Ligjit, të drejtat dhe liritë themelore mund të kufizohen vetëm deri në atë masën e domosdoshme për përmbushjen e qëllimeve jetike të shprehura në nenin 2 të Ligjit. Gjithashtu, neni 54 i Kushtetutës përcakton që çdokush gëzon të drejtën për mjete efektive ligjore në rast se konstatohet se është shkelur një e drejtë e garantuar me Kushtetutë.

79. Z. Thaçi ka kërkuar që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të refuzojë të ushtrojë juridiksionin për shkak të shkeljeve të pretenduara të të drejtave të tij.¹¹⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se refuzimi i ushtrimit të juridiksionit në raste të tilla është çështje e kompetencës diskrecionale.¹¹⁸ Është një proces në të cilin një gjykatës mund të refuzojë të ushtrojë juridiksionin në rastet kur ka shkelje të rënda dhe të jashtëzakonshme të të drejtave të një të akuzuari që kanë pasoja të dëmshme për integritetin e gjykatës.¹¹⁹ Si rrjedhim, refuzimi për të ushtruar juridiksionin mund të përlligjet vetëm në raste të jashtëzakonshme të shkeljeve të të drejtave të njeriut.¹²⁰ Në shumicën e rasteve, një mjet i tillë juridik do të ishte joproporcional krahasuar me dëmin që ka pësuar i akuzuari.¹²¹ Kjo është veçanërisht e vërtetë kur fjala është për interesa më të larta që dalin gjatë proceseve gjyqësore ndaj personave që akuzohen për krime të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare.¹²² Në pjesët në vijim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të shqyrtojë së pari nëse ka pasur shkelje të të drejtave të të akuzuarve. Çështja e refuzimit të ushtrimit të juridiksionit do të shqyrtohet vetëm pasi të jetë konstatuar ndonjë shkelje e të drejtave të të akuzuarve.

¹¹⁷ Mocioni i Thaçit, para. 2, 54.

¹¹⁸ Shih, për ngjashmëri, ICC, [Lubanga Appeal on Jurisdiction](#), para. 28; ICTR, *Prosecutor v. Barayagëiza*, ICTR-97-19-AR72, Appeals Chamber, [Decision](#) ("Barayagëiza Decision"), 3 November 1999, para. 74.

¹¹⁹ Shih, për ngjashmëri, ICC, [Lubanga Appeal on Jurisdiction](#), para. 30; ICTY, *Prosecutor v. Mićo Stanišić*, IT-08-91-A, Appeals Chamber, [Decision on Mićo Stanišić Motion Requesting a Declaration of Mistrial and Stojan Župljanin's Motion to Vacate Trial Judgement](#), 2 April 2014, para. 35; ICTR, [Barayagëiza Decision](#), para. 74.

¹²⁰ ICTY, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-AR73.4, Appeals Chamber, [Decision on Karadžić's Appeal of Trial Chamber's Decision on Alleged Holbrooke Agreement](#), 12 October 2009, para. 45, 46. Shih, për ngjashmëri, ICC, [Lubanga Appeal on Jurisdiction](#), para. 30-31.

¹²¹ ICTY, *Prosecutor v. Šešelj*, IT-03-67-T, Trial Chamber, [Decision on Oral Request of the Accused for Abuse of Process](#) ("Šešelj Decision"), 10 February 2010, para. 22.

¹²² ICTY, [Šešelj Decision](#), para. 22.

1. E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e themeluar me ligj

80. Z. Thaçi parashtron se DHS-ja nuk është gjykatë “e themeluar me ligj” në kuptim të nenit 6(1) të KEDNJ-së.¹²³ Në këtë aspekt, z. Thaçi vë në dukje faktin se Ligji nuk i është referuar asnjëherë GJKK-së për të shqyrtuar përputhshmërinë e tij me Kushtetutën dhe me KEDNJ-në.¹²⁴

81. Z. Thaçi parashtron se DHS-ja ka huazuar shumë nga tiparet e gjykatave të tjera ndërkombëtare ose hibride, të cilat nga ana e tyre kanë përfituar gjithmonë nga fakti që janë konsideruar se veprojnë në përputhje me standardet ndërkombëtare; megjithatë, dispozitat e Kushtetutës kërkojnë që të bëhet një shqyrtim më i përpiktë.¹²⁵ Në këtë aspekt, aktgjykimi i GJKK-së i datës 15 prill 2015 (“Aktgjykimi i GJKK-së”) nuk mund të merret si bazë për të mbrojtur kushtetutshmërinë e DHS-së pasi aktgjykimi në fjalë kishte të bënte vetëm me Amendamentin nr. 24 të Kushtetutës.¹²⁶ Z. Thaçi argumenton se përderisa DHS-ja funksionon *de jure* dhe *de facto* në mënyrë të pavarur dhe të ndarë nga sistemi gjyqësor i Kosovës, ajo shkel haptazi Kushtetutën dhe dispozitën përkatëse të saj që ndalon themelimin e gjykatave të jashtëzakonshme, si dhe nenin 6(1) të KEDNJ-së.¹²⁷

82. Z. Veseli parashtron se, ndonëse GJKK-ja tashmë e ka shqyrtuar çështjen nëse krijimi i DHS-së shkelte nenin 103(7) të Kushtetutës, ajo e bëri këtë shqyrtim në mënyrë të parakohshme sepse nuk bëri një vlerësim të Ligjit.¹²⁸ Z. Veseli parashtron se tani ekziston arsye bindëse për të rishqyrtuar konstatimin e GJKK-së.¹²⁹

83. ZPS-ja përgjigjet se GJKK-ja arriti në përfundimin se krijimi i DHS-së ishte në përputhje me nenin 103(7) të Kushtetutës dhe se parashtrimet e z. Thaçi dhe z. Veseli

¹²³ Mocioni i Thaçi, para. 36-38.

¹²⁴ Mocioni i Thaçi, para. 39.

¹²⁵ Mocioni i Thaçi, para. 40-41.

¹²⁶ Mocioni i Thaçi, para. 41, që i referohet Aktgjykimit të GJKK-së.

¹²⁷ Mocioni i Thaçi, para. 41-43.

¹²⁸ Mocioni i Veselit, para. 3.

¹²⁹ Mocioni i Veselit, para. 4, 21.

në këtë aspekt nuk ngrenë pika të reja dhe, si rrjedhim, duhet të refuzohen.¹³⁰ ZPS-ja argumenton se fakti që GJKK-ja nuk e shqyrtoi Ligjin është i parëndësishëm, pasi të gjithë elementet e kundërshtuara janë trajtuar shprehimisht në dokumentet që GJKK-ja kishte në dispozicion në atë kohë.¹³¹ ZPS-ja argumenton se për sa kohë që DHS-ja (i) vazhdon të funksionojë brenda kornizës së sistemit gjyqësor të Kosovës; (ii) vepron bazuar në ligj; dhe (iii) është e nevojshme, ajo është në përputhje me nenin 103(7) të Kushtetutës.¹³²

84. Z. Thaçi kundërpërgjigjet se ZPS-ja shpërfill faktin që Ligji nuk është shqyrtuar nga GJKK-ja dhe se GJKK-ja nuk doli me ndonjë vlerësim në lidhje me gjykatën që u themelua përfundimisht.¹³³

85. Z. Veseli kundërpërgjigjet se GJKK-ja nuk ka marrë në shqyrtim Ligjin.¹³⁴ Ai argumenton se pretendimi sipas të cilit neni 162 i Kushtetutës parashikonte qartësisht dispozita ligjore të veçanta është i rremë, siç ilustron nga fakti se neni 162(6) i Kushtetutës u referohet konkretisht Rregullave të Procedurës dhe Provave, por jo Ligjit.¹³⁵ Z. Veseli parashtrohet se GJKK-ja thjesht ka bërë një vlerësim *prima facie* se si do të dukej një gjykatë e specializuar, çka nënkuptonte gjithashtu se DHS-ja do të funksiononte mbi bazën e të drejtës penale materiale të Kosovës.¹³⁶

86. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e themeluar me ligj është një e drejtë absolute dhe nuk mund të kufizohet.¹³⁷ E ndërgjegjshme për këtë të drejtë, GJKK-ja, në vlerësimin e Amendamentit nr. 24 të Kushtetutës për themelimin e DHS-së, përcaktoi se dy kriteret formale sipas nenit

¹³⁰ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 3.

¹³¹ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 4-8.

¹³² Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 9-14, 18.

¹³³ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 2-3.

¹³⁴ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 5.

¹³⁵ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 6-9.

¹³⁶ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 10-14.

¹³⁷ Human Rights Committee, CCPR/C/GC/32, *General Comment No. 32* ("HRC General Comment No. 32"), 23 August 2007, para. 18.

103(7) të Kushtetutës, konkretisht, krijimi i një gjykate të specializuar që të jetë: (i) e bazuar në ligj; dhe (ii) e nevojshme, ishin përmbushur.¹³⁸ Duke trajtuar kriterin “bazuar në ligj”, GJKK-ja iu referua jurisprudencës së GJEDNJ-së, duke vënë në dukje se kriteri “e themeluar me ligj” i përcaktuar në nenin 6 të KEDNJ-së ekziston për të siguruar që organizimi gjyqësor të mos varet nga kompetenca diskrecionale e ekzekutivit, por përkundrazi të rregullohet me ligj që buron nga Parlamenti.¹³⁹ GJKK-ja konstatoi se kriteri “e themeluar me ligj” ishte përmbushur nga fakti që Amendamenti nr. 24, tani neni 162 i Kushtetutës, e inkuađroi DHS-në në sistemin gjyqësor të Kosovës dhe shtroi nevojën për miratimin e një ligji të veçantë nga Kuvendi i Kosovës, i cili do të rregullonte organizimin, funksionimin dhe juridiksionin.¹⁴⁰ Si rrjedhim, GJKK-ja parashikoi qartë që do të miratohej një ligj i veçantë. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Ligji në fakt u miratua nga Kuvendi i Kosovës më 3 gusht 2015.

87. Siç u shtjellua më lart, kriteri “e themeluar me ligj” që pasqyron parimin e sundimit të ligjit, kërkon të sigurojë ekzistencën e një baze ligjore për themelimin e gjyqësorit dhe mbron gjyqësorin nga ndikimet e jashtme të paligjshme, veçanërisht nga pushteti ekzekutiv.¹⁴¹ GJKK-ja e vlerësoi Amendamentin nr. 24 dhe themelimin e DHS-së nga ky këndvështrim dhe theksoi se Kuvendi i Kosovës do të miratonte një ligj të veçantë që do të rregullonte organizimin, funksionimin dhe juridiksionin e DHS-së. Fakti që Ligji u miratua pas vendimit të GJKK-së nuk cenon konstatimet e GJKK-së. Kjo veçanërisht për faktin se GJKK-ja ishte njohur në vija të përgjithshme në atë kohë me veçoritë përkatëse të Ligjit përmes Shkëmbimit të Letrave.¹⁴² Në lidhje me

¹³⁸ Aktgjykimi i GJKK-së, para. 45-53.

¹³⁹ Aktgjykimi i GJKK-së, para. 47-48, që i referohet GJEDNJ-së, *Fruni v. Slovakia*, no. 8014/07, [Judgment](#), 21 June 2011, para. 142; *Erdem v. Germany*, no. 38321/97, [Decision](#), 9 December 1999. Shih gjithashtu, ECtHR, *Richert v. Poland*, no. 54809/07, [Judgment](#), 25 tetor 2011, para. 42.

¹⁴⁰ Neni 162(1) i Kushtetutës; Aktgjykimi i GJKK-së, para. 46, 55.

¹⁴¹ ECtHR, *Guðmundur Andri Ástráðsson v. Iceland* [GC] (“*Guðmundur Andri Ástráðsson v. Iceland* [GC]”), no. 26374/18, [Judgment](#), 1 December 2020, para. 236.

¹⁴² Aktgjykimi i GJKK-së, para. 38.

këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Shkëmbimi i Letrave parashikonte krijimin e një gjykate të specializuar me: (i) dhoma të veçanta e të dedikuara gjyqësore; (ii) personel ndërkombëtar; (iii) statutin dhe rregulloren e procedurës dhe provave; (iv) përfshirjen e BE-së; dhe (v) një sistem të pavarur për përzgjedhjen dhe emërimin e gjykatësve.¹⁴³ Gjithashtu, natyra e specializuar e juridiksionit të DHS-së u përcaktua shprehimisht në nenin 162(1) të Kushtetutës dhe u njoh nga GJKK-ja si bazë për vërtetimin e nevojës së saj.¹⁴⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se neni 6(1) i KEDNJ-së nuk kërkon që ligjvënësi të përcaktojë në detaje secilin element të funksionimit të gjykatës në qoftë se është krijuar me ligj një kornizë e organizimit gjyqësor të saj.¹⁴⁵

88. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se DHS-ja është qartësisht e bazuar në ligj.

2. E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme

89. Gjykatësi i Procedurës Paraprake tani do të shqyrtojë nëse disa aspekte të Ligjit, siç janë parashtruar nga z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi, bien ndesh me konceptin se DHS-ja është gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

90. Z. Thaçi parashtron se DHS-ja nuk i përmbush kriteret e pavarësisë dhe paanësisë të përcaktuara në nenin 6(1) të KEDNJ-së ose standardet e tjera ndërkombëtare përkatëse.¹⁴⁶ Z. Thaçi kundërshton veçoritë e mëposhtme të DHS-së, për të cilat pretendon se vënë në rrezik aftësinë e saj për të funksionuar në mënyrë autonome: (i) mënyrën e financimit dhe auditimit që përfshin “shtetet e treta kontribuese” si dhe punësimin e personelit të emëruar përmes autoriteteve shtetërore, përfshirë Prokurorin e Specializuar; (ii) mungesën e afateve të caktuara të punësimit të gjykatësve dhe “natyrën e paqartë të dispozitave legislative” në lidhje me Panelin

¹⁴³ Shkëmbimi i Letrave, f. 8-9.

¹⁴⁴ Aktgjykimi i GJKK-së, para. 51-53.

¹⁴⁵ ECtHR, *Zand v. Austria*, 7360/76, 12 October 1978, para. 69.

¹⁴⁶ Mocioni i Thaçit, para. 47, 49-51.

Përzgjedhës për emërimin e gjykatësve; (iii) shpërblimin e gjykatësve në bazë të ditëve të punës; (iv) paqartësinë e dispozitave që rregullojnë heqjen e gjykatësve të DHS-së; (v) kompetencën diskrecionale që i është dhënë Kryetares së DHS-së për caktimin e gjykatësve në panele në bazë të Regjistrisë; (vi) përfshirjen e Shefit të EULEX-it në emërimin dhe heqjen e gjykatësve si dhe në organizimin administrativ dhe financiar të DHS-së; dhe (vii) moszbatueshmërinë e rregulloreve të Kosovës në lidhje me emërimin, administrimin dhe mjetet juridike ndaj gjykatësve dhe prokurorëve.¹⁴⁷

91. Z. Veseli argumenton se natyra *de facto* e jashtëzakonshme e DHS-së dëshmohehet nga fakti se (i) ajo u krijua për të gjykuar një grup të caktuar çështjesh;¹⁴⁸ (ii) procedura e ndjekur prej saj për emërimin e gjykatësve ka shmangur Kapitullin VII të Kushtetutës, që ilustron me faktin se gjykatësit e DHS-së nuk kanë lidhje zyrtare me gjyqësorin e Kosovës;¹⁴⁹ dhe (iii) DHS-ja ka përparësi kundrejt të gjitha gjykatave të tjera të Kosovës dhe nuk zbaton procedurën penale dhe ligjet përkatëse të Kosovës.¹⁵⁰

92. Z. Selimi parashtrohet se praktika e punësimit e zbatuar nga DHS-ja dhe ZPS-ja, e cila ndalon që shqiptarët e Kosovës të punësohen në këto institucione, përveçse diskriminuese dhe e padrejtë, nuk parashikohet në Ligj,¹⁵¹ është në dallim të dukshëm me faktin se ato përfaqësojnë çdo nivel të sistemit të gjykatave në Kosovë¹⁵² dhe në kundërshtim me praktikën e gjykatave të tjera hibride dhe të përkohshme.¹⁵³ Gjithashtu, z. Selimi argumenton se duket se nenet 26 dhe 28 të Ligjit bazohen në

¹⁴⁷ Mocioni i Thaçit, para. 48.

¹⁴⁸ Mocioni i Veselit, para. 8-9. Në lidhje me mocionin e Veselit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se kundërshtimet e z. Veseli janë kufizuar vetëm në kontekstin e pretendimit për krijimin e një gjykate të jashtëzakonshme dhe me synimin për të kërkuar një referim tek DHSGJK-ja; megjithatë, meqenëse kundërshtimet në lidhje me emërimin e gjykatësve dhe strukturën ligjore të DHS-së prekin gjithashtu pavarësinë dhe paanësinë e DHS-së, ato do të trajtohen së bashku me argumentet e ngjashme të parashtruara nga z. Thaçi dhe z. Selimi. Kundërshtimet e z. Veseli lidhur me juridiksionin lëndor të DHS-së dhe kërkesa e tij për referim tek DHSGJK-ja do të trajtohen më poshtë.

¹⁴⁹ Mocioni i Veselit, para. 10-11.

¹⁵⁰ Mocioni i Veselit, para. 12-19.

¹⁵¹ Mocioni i Selimit, para. 9, 13-14

¹⁵² Mocioni i Selimit, para. 5.

¹⁵³ Mocioni i Selimit, para. 11.

supozimin se vetëm gjykatësit ndërkombëtarë mund të jenë të pavarur.¹⁵⁴ Sipas mendimit të z. Selimi, praktikat e punësimit të DHS-së përbëjnë një mohim themelor të drejtësisë për popullin e Kosovës dhe për të akuzuarit, në shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 7 të Kushtetutës¹⁵⁵ dhe të nenit 14 të KEDNJ-së, i cili ndalon diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë.¹⁵⁶

93. ZPS-ja përgjigjet se Kushtetuta, Ligji, Rregullorja e Procedurës dhe Provave, Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve dhe Kodi i Etikës Gjyqësore ofrojnë një kornizë gjithëpërfshirëse për paraqitjen e kandidaturave, emërimin, heqjen dhe kohën e qëndrimit në detyrë të gjykatësve, që kufizon dhe shmang ushtrimin e kompetencës diskrecionale në punën e DHS-së, duke garantuar pavarësinë e saj nga ndërhyrjet e jashtme.¹⁵⁷ ZPS-ja argumenton se DHSGJK-ja tashmë e ka miratuar kornizën organizative dhe bartjen ekzistuese të kompetencave tek Kryetarja e Dhomave të Specializuara.¹⁵⁸ Sa i përket gjykatësve të DHS-së, ZPS-ja u referohet neneve 27(1), 31(1), dhe 33(4) dhe (5) të Ligjit, të cilat garantojnë që gjykatësit e DHS-së janë persona me moral të lartë, të paanshëm, me integritet dhe që kryejnë funksionet e tyre në përputhje me Kushtetutën dhe me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.¹⁵⁹ Gjithashtu, ZPS-ja pretendon se as mënyra e financimit, as përfshirja e EULEX-it dhe as praktika e emërimit të personelit ndërkombëtar përmes autoriteteve shtetërore nuk bien ndesh me kriterin e pavarësisë, për sa kohë që korniza normative e përshkruar më sipër garanton pavarësinë nga ndërhyrjet e jashtme.¹⁶⁰ ZPS-ja parashton se pretendimi i z. Thaçi në lidhje me Prokurorin e Specializuar është i pathemeltë dhe se gjithsesi kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë të përcaktuara në nenin 6(1) të

¹⁵⁴ Mocioni i Selimit, para. 7.

¹⁵⁵ Mocioni i Selimit, para. 14-16.

¹⁵⁶ Mocioni i Selimit, para. 17-19.

¹⁵⁷ Përgjigjja e ZPS, F260, para. 14.

¹⁵⁸ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 14, që i referohet Aktvendimit mbi Referimin e Rregullores Miratuar më 17 mars 2017, para 33- 34.

¹⁵⁹ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 16.

¹⁶⁰ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 16-17.

KEDNJ-së nuk kanë të bëjnë me një palë të veçantë në proces, por me gjykatën në tërësi.¹⁶¹

94. Në lidhje me parashtrimet e z. Veseli, ZPS-ja përgjigjet se kriteret e Komisionit të Venecias nuk e ndryshojnë analizën e saj.¹⁶² Gjithashtu, ZPS-ja përgjigjet se ka gjykata që janë krijuar me juridiksion shumë më të kufizuar se DHS-ja dhe, si rrjedhim, DHS-ja nuk është një institucion unik ose i pandeshur ndonjëherë në historinë e drejtësisë penale bashkëkohore.¹⁶³ ZPS-ja argumenton se personeli ndërkombëtar i DHS-së, procedura e veçantë e emërimit të gjykatësve dhe funksionimi mbi bazën e statutit dhe rregullave të veta nuk ndikojnë në kushtetutshmërinë e DHS-së.¹⁶⁴ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se përparësia e DHS-së ndaj gjykatave të tjera të Kosovës thjesht pasqyron statusin e saj si gjykatë e specializuar.¹⁶⁵

95. Së fundi, ZPS-ja përgjigjet se kundërshtimet e z. Selimi duhet të hidhen poshtë menjëherë përderisa është e pamundur të përcaktohet lidhja që kanë me aspektin e juridiksionit të DHS-së.¹⁶⁶ Në veçanti, ZPS-ja parashtron se z. Selimi nuk tregon se me cilat të drejta lidhet diskriminimi i pretenduar dhe si ndikon një diskriminim i tillë mbi të akuzuarin dhe në ushtrimin e juridiksionit të DHS-së mbi të.¹⁶⁷

96. Z. Thaçi kundërpërgjigjet se ZPS-ja nuk ka marrë parasysh jurisprudencën më të fundit të përditësuar të GJEDNJ-së dhe ka keqkuptuar e keqinterpretuar jurisprudencën e GJEDNJ-së të cituar nga Mbrojtja.¹⁶⁸ Ai argumenton se fakti që GJEDNJ-ja nuk kishte konstatuar shkelje në çështjen *Fruni* nuk mund të interpretohet si mbështetje e sugjerimit të përgjithshëm se gjykatat e specializuara penale

¹⁶¹ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 15.

¹⁶² Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 19.

¹⁶³ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 19-20.

¹⁶⁴ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 21.

¹⁶⁵ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 21.

¹⁶⁶ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 23.

¹⁶⁷ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 23-24.

¹⁶⁸ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 4-10.

funksionojnë gjithmonë në përputhje me KEDNJ-në.¹⁶⁹ Z. Thaçi më tej parashtron se largimi nga detyra i Prokurorit të Specializuar të mëparshëm tregon pavarësinë e kufizuar funksionale në të cilën ai vepronte dhe përbën shkelje të nenit 35(5) të Ligjit.¹⁷⁰

97. Z. Veseli kundërpërgjigjet se DHS-ja shkel drejtpërdrejt nenin 55 të Kushtetutës duke i dhënë përparësi Ligjit të saj ndaj legjislacionit penal vendor.¹⁷¹ Për të vlerësuar nëse DHS-ja është një gjykatë e specializuar apo e jashtëzakonshme, z. Veseli parashtron se duhet t'u kushtohet vëmendje kriterëve të miratuara nga Komisioni i Venecias dhe jo kriterëve zyrtarë të nenit 103(7) të Kushtetutës.¹⁷² Gjithashtu, z. Veseli parashtron se krahasimet e bëra me gjykatat hibride ndërkombëtare janë të papërshtatshme.¹⁷³ Z. Veseli kërkon që kjo çështje t'i referohet urgjentisht DHSGJK-së.¹⁷⁴

98. Z. Selimi kundërpërgjigjet se pretendimi sipas nenit 14 të KEDNJ-së lidhet me të drejtën e tij për gjykim të drejtë, dhe në veçanti me kriterin “e themeluar me ligj” të parashikuar në nenin 6(1) të KEDNJ-së, dhe jo me pretendimin e përgjithshëm për diskriminim në emër të shqiptarëve të Kosovës.¹⁷⁵ Z. Selimi parashtron se sipas Kushtetutës, ai ka të drejtën të gjykohej nga një trup gjykues në të cilin përfshihen edhe gjykatës nga Kosova dhe nga një gjykatë që nuk diskriminon shqiptarët e Kosovës.¹⁷⁶ Z. Selimi parashtron se “perceptimet gjithashtu mund të jenë të rëndësishme”, dhe se përjashtimi i të gjithë shqiptarëve të Kosovës nga DHS-ja konkretisht nënkupton që asnjë anëtar i grupit të tij etnik të mos përfaqësohet në asnjë nga njësitë e DHS-së, duke krijuar kështu mundësinë për anësi, në mënyrë të

¹⁶⁹ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 6.

¹⁷⁰ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 12-15.

¹⁷¹ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 5.

¹⁷² Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 16-18.

¹⁷³ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 19-20.

¹⁷⁴ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 21.

¹⁷⁵ Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 4-11, 13-27. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kupton se parashtrimet e z. Selimi kundërshtojnë praktikën e punësimit të DHS-së sipas dispozitës së nenit 6(1) të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, parashtrimet e tij do të shqyrtohen brenda këtij kuadri.

¹⁷⁶ Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 29.

vetëdijshme apo të pavetëdijshme dhe duke e distancuar DHS-në nga populli dhe kultura ligjore e Kosovës.¹⁷⁷

99. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, sipas nenit 6(1) të KEDNJ-së, pavarësia kryesisht nënkupton pavarësinë nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ, por edhe pavarësi nga palët.¹⁷⁸ Paanësia zakonisht nënkupton mungesën e paragjykitimit ose anësisë dhe ekzistenca e tyre mund të analizohet në mënyra të ndryshme.¹⁷⁹ Ekzistojnë dy metoda për të analizuar paanësinë. Sipas metodës subjektive, duhet të përcaktohet bindja ose interesi personal i një gjykatësi të caktuar në një çështje konkrete.¹⁸⁰ Sipas metodës objektive për analizimin e paanësisë, duhet të përcaktohet nëse pavarësisht prej veprimeve personale të ndonjërit prej anëtarëve të gjykatës, ka fakte të vërtetueshme të cilat mund të ngrenë dyshime për paanshmërinë e atij organi.¹⁸¹ Është konstatuar se “analiza objektive kryesisht ka të bëjë me lidhjet hierarkike ose të llojeve të tjera midis gjykatësit dhe protagonistëve të tjerë në proces”, dhe rrjedhimisht, duhet të “vendoset për secilin rast të veçantë nëse marrëdhënia në fjalë është e një lloji dhe shkalle të tillë që tregon një mungesë të paanësisë nga ana e gjykatës”.¹⁸²

100. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se i akuzuari nuk vuri në pikëpyetje paanësinë subjektive të Gjykatësit të Procedurës Paraprake ose të ndonjë gjykatësi tjetër të DHS-së. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon me vend të shqyrtojë ankesat e të akuzuarve nga pikëpamja e kriterëve të pavarësisë dhe paanësisë objektive, të cilat janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe duhen

¹⁷⁷ Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 30.

¹⁷⁸ *Shih* ECtHR, *Maktouf and Damjanović v. Bosnia and Herzegovina* [GC] (“*Maktouf and Damjanović v. Bosnia and Herzegovina* [GC]”), nos. 2312/08 and 34179/08, [Judgment](#), 18 July 2013, para. 49.

¹⁷⁹ ECtHR, *Kyprianou v. Cyprus* [GC], no. 73797/01 (“*Kyprianou v. Cyprus* [GC]”), [Judgment](#), 15 dhjetor 2005, para. 118; ECtHR, *Micallef v. Malta*, no. 17056/06, [Judgment](#), 15 October 2009, para. 93.

¹⁸⁰ ECtHR, *Kyprianou v. Cyprus* [GC], para 118-119.

¹⁸¹ *Shih* ECtHR, *Bochan v. Ukraine* (“*Bochan v. Ukraine*”), no. 7577/02, [Judgment](#), 3 May 2007, para. 66.

¹⁸² ECtHR, *Bahaettin Uzan v. Turkey* (“*Bahaettin Uzan v. Turkey*”), no. 30836/07, [Judgment](#), 24 November 2020, para. 57; *Ramos Nunes Carvalho e Sá v. Portugal* [GC], nos. 55391/13, 57728/13, 74041/13, [Judgment](#), 6 November 2018, para. 148.

shqyrtuar së bashku.¹⁸³ Në vlerësimin e pavarësisë dhe paanësisë së një gjykate ose tribunali, ndër të tjera, duhet të merret parasysh mënyra e emërimit të anëtarëve të saj, kohëzgjatja e qëndrimit të tyre në detyrë, ekzistenca e garancive kundër ndërhyrjeve të jashtme dhe fakti nëse gjykata krijon perceptimin se është e pavarur.¹⁸⁴ Si rrjedhim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të shqyrtojë kundërshtimet e të akuzuarve brenda këtij kuadri.

101. Për vlerësimin e pavarësisë dhe paanësisë së DHS-së duhet t'i kushtohet vëmendje kornizës së gjerë që udhëheq punën e DHS-së.¹⁸⁵ Në krye të kësaj hierarkie është Kushtetuta, pasi DHS-ja është e detyruar të gjykojë dhe funksionojë në përputhje me të.¹⁸⁶ Rrjedhimisht, çdo pretendim se DHS-ja vepron tërësisht jashtë ligjeve që zbatohen në Kosovë ose se ajo nuk u nënshtrohet kufizimeve hierarkike, është një shtrembërim i kornizës ligjore të DHS-së. Fakti që DHS-ja ka përparësi ndaj gjykatave të tjera në Kosovë nuk ndikon në këtë analizë pasi këto kufizime janë përfshirë në kornizën ligjore të DHS-së. DHS-ja është e detyruar të funksionojë në përputhje me, ndër të tjera, Ligjin si *lex specialis* dhe të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.¹⁸⁷ Në këto rrethana, dhe duke qenë se nuk konstatohet ndonjë shkelje e kësaj kornize ligjore, perceptimi për pavarësinë dhe paanësinë e kësaj gjykate bëhet edhe më i fortë.¹⁸⁸

102. Sa i përket mënyrës së emërimit të gjykatësve në DHS, z. Thaçi përmend natyrën e paqartë të procedurave në lidhje me Panelin Përzgjedhës.¹⁸⁹ Për sa i takon Panelit Përzgjedhës, Gjykatësi i Procedurës paraprake gjykon se neni 28 i Ligjit përcakton

¹⁸³ ECtHR, *Moiseyev v. Russia*, no. 62936/00, [Judgment](#), 9 October 2008, para. 175; [Bahaettin Uzan v. Turkey](#), para. 58.

¹⁸⁴ *Shih*, për ngjashmëri ECtHR, [Maktouf and Damjanović v. Bosnia and Herzegovina \[GC\]](#), para. 49.

¹⁸⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se kjo kornizë e gjerë përfshin dispozitat përkatëse të Kushtetutës dhe Ligjin, si dhe Rregulloren e Procedurës dhe Provave, Rregulloren për Caktimin e Gjykatësve dhe Kodin e Etikës Gjyqësore që plotësojnë këto dispozita.

¹⁸⁶ Neni 3(2)(a) i Ligjit.

¹⁸⁷ Neni 3(2)(e) i Ligjit.

¹⁸⁸ ECtHR, [Kyprianou v. Cyprus \[GC\]](#), para. 119.

¹⁸⁹ Mocioni i Thaçit, para. 48(ii) dhe (v).

qartë sistemin e përzgjedhjes për emërimin e gjykatësve në Regjistër, duke përfshirë: (i) rolin¹⁹⁰ dhe përbërjen¹⁹¹ e Panelit Përzgjedhës; (ii) mënyrën e finalizimit të listës me emrat e kandidatëve që rekomandohen të punësohen si gjykatës;¹⁹² dhe (iii) rolin e Autoritetit Emërues për vendosjen e gjykatësve të përzgjedhur në Regjistër.¹⁹³ Duke theksuar se Ligji krijon një organ të pavarur për emërimin e gjykatësve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se mekanizmi i emërimit të gjykatësve në DHS e veçon procesin e emërimit nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv, duke garantuar në këtë mënyrë pavarësinë dhe paanësinë e saj.¹⁹⁴ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se mënyra e emërimit të gjykatësve në DHS nuk vë në dyshim pavarësinë dhe paanësinë e DHS-së.

103. Për sa i përket kohëzgjatjes së caktimit të gjykatësve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se nuk është specifikuar ndonjë afat minimal i domosdoshëm i qëndrimit të tyre në detyrë,¹⁹⁵ por gjykatësit duhet të gëzojnë një lloj stabiliteti, qoftë edhe për një periudhë të përcaktuar.¹⁹⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se në DHS, kur caktohen nga Regjistri për të marrë pjesë në një proces gjyqësor, gjykatësit caktohen për një mandat katërvjeçar ose deri në përfundimin e fazës së procesit, në rast se ajo fazë përfundon më herët.¹⁹⁷ Gjithashtu, Ligji garanton që caktimi i gjykatësve përfundon vetëm kur të ketë përfunduar procesi.¹⁹⁸ Neni 31(4) i Ligjit

¹⁹⁰ Neni 28(1) i Ligjit.

¹⁹¹ Neni 28(2) i Ligjit.

¹⁹² Neni 28(3) i Ligjit.

¹⁹³ Neni 28(3) dhe (4) i Ligjit.

¹⁹⁴ UN Special Rapporteur Diego García-Sayán, *Report* (2018) UN DOC. A/HRC/38/38, 2 May 2018, para. 48, 66, 97-98. Shih gjithashtu, ECtHR, *Henryk Urban and Ryszard Urban v. Poland*, no. 23614/08, [Judgment](#), 30 November 2010, para. 49; [Campbell and Fell v. UK](#), para. 79; [Maktouf and Damjanović v. Bosnia and Herzegovina \[GC\]](#), para. 49.

¹⁹⁵ Shih ECtHR, [Campbell and Fell v. UK](#), para. 80; [Maktouf and Damjanović v. Bosnia and Herzegovina \[GC\]](#), para. 49, 51.

¹⁹⁶ Shih ECtHR, *Sutter v. Switzerland*, 8209/78, Decision, 1 March 1979, para. 2; HRC General Comment No. 32, para. 19; UN Basic Principles on the Independence of the Judiciary /Parimet themelore të Kombeve të Bashkuara mbi Pavarësinë e Gjyqësorit, para. 11-12. Shih gjithashtu, International Association of Judges, *The Universal Charter of Judges*, 17 November 1999, article 2-2.

¹⁹⁷ Neni 30(3) i Ligjit.

¹⁹⁸ Neni 33(1)-(3) i Ligjit.

garanton që asnjë gjykatës nuk përjashtohet, përveç nëse gjykatësit e tjerë, me shumicë absolute, vërtetojnë se ai ose ajo nuk i plotëson më kriteret e pavarësisë dhe paanësisë, të mishëruara në nenet 27 dhe 31 të Ligjit. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, ndonëse caktimi i një gjykatësi mund të përfundojë, ai ose ajo mbetet në Regjistër dhe në dispozicion për të kryer detyra të tjera që mund t'i caktohen.¹⁹⁹ Duke pasur parasysh që gjykatësit e DHS-së janë të mbrojtur nga përjashtimi arbitrar, caktimi i tyre përfundon vetëm pas përmbylljes së proceseve gjyqësore, pa qenë nevoja të plotësojnë kritere shtesë, dhe, duke qenë që qëndrimi në detyrë i tyre për një afat të përcaktuar përputhet me natyrën e përkohshme të DHS-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se afati i qëndrimit në detyrë të gjykatësve nuk vë në dyshim pavarësinë dhe paanësinë e DHS-së.²⁰⁰

104. Sa i përket pagesës së gjykatësve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se gjykatësit e DHS-së paguhen pas caktimit për të ushtruar funksionet e tyre në një çështje gjyqësore ose apel dhe për aq kohë sa zgjat shqyrtimi i çështjes gjyqësore ose apelit.²⁰¹ Kjo skemë shpërblimi financiar nuk ndikon në pavarësinë gjyqësore pasi kjo rregullohet nga Ligji, i cili është miratuar para emërimit të gjykatësve dhe nuk ka natyrë diskrecionale, për rrjedhim, nuk mund të manipulohet nga faktorët e jashtëm.²⁰² Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se skema e shpërblimit financiar të gjykatësve që zbaton DHS-ja nuk vë në dyshim pavarësinë dhe paanësinë e Dhomave të Specializuara.

105. Për sa i takon përjashtimit të gjykatësve, neni 31(4) i Ligjit parashikon që asnjë gjykatës nuk përjashtohet, përveç nëse gjykatësit e tjerë, me shumicë absolute, vërtetojnë se gjykatësi nuk i plotëson më kriteret e përcaktuara në nenet 27 dhe 31 të

¹⁹⁹ Nenet 28(4) dhe 33(1)-(3) të Ligjit.

²⁰⁰ Shih ECtHR, *Maktouf and Damjanović v. Bosnia and Herzegovina* [GC], para. 51.

²⁰¹ Shih nenet 26(2) dhe (3) të Ligjit.

²⁰² Shih SCSL, *Prosecutor v. Norman*, SCSL-2004-14-AR72(E), *Decision on Preliminary Motion Based on Lack of Jurisdiction (Judicial Independence)*, 13 March 2004, para. 37-38. Gjykata të tjera kanë skema të ngjashme për pagesat. Shih *p.sh.*, IRMCT, UNSC Res. 1966, Statute of the International Residual Mechanism for Criminal Tribunals, 22 December 2010, article 8(4).

Ligjit. Rregulla 22 e Rregullores parashikon që përjashtimi nga Regjistri, në përputhje me nenin 31(4) të Ligjit, rregullohet nga Kodi i Etikës Gjyqësore dhe ky i fundit nga ana e tij përsërit nenin 31(4) të Ligjit. Kodi i Etikës Gjyqësore parashikon që kur gjykatësit konstatojnë se janë vërtetuar një apo më shumë pretendime për sjellje kundërvajtëse të rënda, gjykatësit e mbledhur në seancë plenare, me shumicë absolute, vendosin nëse gjykatësi duhet përjashtuar.²⁰³ Gjithashtu, Kreu 4 i Kodit të Etikës Gjyqësore përcakton një procedurë të zgjeruar për shqyrtimin e ankesave të mundshme kundër gjykatësve, e cila përfshin një Komision Disiplinor që përbëhet nga dy gjykatës të jashtëm dhe një gjykatës i emëruar i lartë i BE-së. Përdorimi i një arbitri të jashtëm, siç është Komisioni Disiplinor, jo vetëm shmang vënien e DHS-së nën presionin e faktorëve të jashtëm, por garanton edhe që procesi i shqyrtimit të ankesave ndaj gjykatësve të jetë neutral. Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se neni 31(4) i Ligjit dhe rregullat e dispozitat e Kodit të Etikës Gjyqësore në lidhje me të, të cituara më sipër, mbështesin parimin e përgjithshëm të mosheqjes së gjykatësit, duke bërë të mundur përjashtimin e tij vetëm në rastet kur ka arsye për sjellje kundërvajtëse të rëndë dhe vetëm pasi të jetë ndjekur procedurat e përcaktuara qartë në Kreun 4 të Kodit të Etikës Gjyqësore. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se korniza ligjore e DHS-së në lidhje me përjashtimin e gjykatësve nuk vë në dyshim pavarësinë dhe paanësinë e Dhomave të Specializuara.

106. Sa i përket rolit të Kryetarit të DHS-së për caktimin e gjykatësve nga Regjistri, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se Kryetari i DHS-së ka kompetencën të caktojë gjykatësit nga Regjistri, në përputhje me nenet 32(3) dhe 33 të Ligjit. Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve të DHS-së u nxor në pajtim me nenin 25(3) të Ligjit me qëllimin për të udhëzuar Kryetarin në këtë drejtim. Në këtë aspekt, Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve rendit një numër kriteresh të cilat Kryetari duhet t'i ketë parasysh para se të caktojë një gjykatës; në këto kritere përfshihen:

²⁰³ Neni 21 i Kodit të Etikës Gjyqësore.

përvoja, kompetenca, përparësia në bazë të datës së emërimit ose të moshës, përfaqësimi gjinor dhe gjeografik, si dhe parapëlqimet e gjykatësve dhe disponueshmëria e tyre.²⁰⁴ Rregullorja gjithashtu përcakton se gjatë caktimit merret parasysh veprimtaria e mëhershme e gjykatësve që me gjasë vë në dyshim paanshmërinë e tyre apo ndikon në ndershmërinë e procesit.²⁰⁵ Gjithashtu, neni 33(4) i Ligjit ofron udhëzime të mëtejshme në lidhje me caktimin e gjykatësve duke përcaktuar se kur një gjykatës caktohet si Gjykatës i Procedurës Paraprake apo anëtar i ndonjë paneli për ndonjë çështje, ai nuk mund të jetë anëtar i ndonjë paneli tjetër në një fazë tjetër të së njëjtës çështjeje gjyqësore. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se korniza ligjore për caktimin e gjykatësve në DHS vendos kritere të parapërcaktuara, të përgjithshme dhe objektive, të cilat ofrojnë garanci kundër caktimit të gjykatësve për motive të palejueshme.²⁰⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej gjykon se aty ku këto rregulla i japin Kryetarit kompetencë diskrecionale, kjo lloj kompetence është një element i domosdoshëm që mundëson elasticitet dhe marrjen parasysh të rrethanave që paraqiten. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se korniza ligjore e DHS-së në lidhje me rolin e Kryetarit në caktimin e gjykatësve nuk vë në dyshim pavarësinë dhe paanësinë e Dhomave të Specializuara.²⁰⁷

107. Për sa i takon përfshirjes së përfaqësuesve të BE-së në emërimin dhe përjashtimin e gjykatësve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se përfshirja e një administratori ndërkombëtar në funksionimin administrativ të një gjykate në vetvete nuk ndikon në pavarësinë dhe paanësinë e asaj gjykate.²⁰⁸ Tekstet juridike të DHS-së parashikojnë dy role për një përfaqësues apo entitet të BE-së në lidhje me emërimin ose përjashtimin e gjykatësve, përkatësisht rolin si Autoritet Emërues²⁰⁹ dhe si anëtar

²⁰⁴ Rregulla 4 e Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

²⁰⁵ Rregulla 4(3) e Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

²⁰⁶ UN Basic Principles on the Independence of the Judiciary, Principle 10.

²⁰⁷ *Shih gjithashtu* Aktvendimi mbi Referimin e Rregullores miratuar më 17 mars 2017, para. 33-34.

²⁰⁸ *Shih* ECtHR, *Maktouf and Damjanović v. Bosnia and Herzegovina* [GC], para. 51-52.

²⁰⁹ Sipas nenit 28(3) dhe (4) të Ligjit, Shefi i Misionit të BE-së për Politikë të Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrotjes, që njihet edhe si Autoriteti Emërues, emëron personat nga lista e Panelit Përzgjedhës si

i Komisionit Disiplinor.²¹⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, në lidhje me funksionin si Autoritet Emërues, roli që ai luan për emërimin dhe përjashtimin e gjykatësve është minimal dhe kryesisht administrativ, pasi ka të bëjë me emërimin dhe vendosjen e gjykatësve në Regjistër. Verifikimi dhe përzgjedhja e gjykatësve bëhet nga Paneli Përzgjedhës, i cili përbëhet nga tre anëtarë ndërkombëtarë, dy prej të cilëve duhet të jenë gjykatës. Sa i përket Komisionit Disiplinor, i emëruari i lartë i BE-së është vetëm një nga anëtarët e jashtëm të Komisionit dhe përfshirja e aktorëve të jashtëm garanton asnjësinë e procesit të shqyrtimit të ankesave ndaj gjykatësve. Duke pasur parasysh këta faktorë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk ka arsye për të vënë në dyshim pavarësinë dhe paanësinë e Dhomave të Specializuara.

108. Sa u përket pretendimeve të pabaza të z. Thaçi në lidhje me largimin e ish-Prokurorit të Specializuar,²¹¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se kriteret që kanë lidhje me pavarësinë dhe paanësinë sipas nenit 6(1) të KEDNJ-së, zbatohen për subjektin që gjykon në lidhje me akuzat penale, d.m.th. për gjykatën, dhe jo për palët pjesëmarrëse në proces.²¹² Si rezultat, çdo rrethanë e supozuar që lidhet me largimin e ish-Prokurorit të Specializuar nuk krijon arsye për të vënë në dyshim pavarësinë dhe paanësinë e Dhomave të Specializuara.

109. Për sa i takon mënyrës së financimit dhe auditimit të DHS-së që përfshin shtetet e treta kontribuese, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se lidhur me çështjen e financimit, duhet pasur kujdes të sigurohet që financimi të mos varet nga luhatjet politike dhe që autoritetet e pushtetit ekzekutiv apo ato të pushtetit legjislativ të mos

gjykatës në Dhomat e Specializuara dhe i vendos ata në Regjistër për aq kohë sa ekzistojnë Dhomat e Specializuara. Sipas nenit 32(1) dhe (4) të Ligjit, Autoriteti Emërues emëron gjithashtu Kryetarin dhe nënkryetarin e DHS-së në bazë të rekomandimeve të Panelit Përzgjedhës. Sipas rregullës 21(2) të Rregullores, pas dorëheqjes ose vdekjes së një gjykatësi, Kryetari njofton Autoritetin Emërues.

²¹⁰ Komisioni Disiplinor, që përbëhet nga tre anëtarë, njëri prej të cilëve është një anëtar i emëruar i lartë i BE-së, heton pretendimet kundër gjykatësve të paraqitura në ankesën e përcjellë nga Kryetari i DHS-së, *shih* neni 18 i Kodit të Etikës Gjyqësore.

²¹¹ Mocioni i Thaçit, para. 48, poshtëshënimi 92.

²¹² ECtHR, *Kontalexis v. Greece*, no. 58000/08, [Judgment](#), 31 May 2011, para. 57; *Harde v. Iceland*, no. 66847/12, [Judgment](#), 23 November 2017, para. 94.

mund të ushtrojnë presion mbi gjyqësorin kur përcaktojnë buxhetin e tij.²¹³ Si rrjedhim, nocionet e pavarësisë dhe paanësisë nuk e ndalojnë përdorimin e kontributeve vullnetare të shteteve të ndryshme apo të organizatave ndërkombëtare, nëse vendimet e tyre për buxhetin nuk ushtrojnë presion mbi gjyqësorin. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se z. Thaçi nuk demonstroi se si kjo mënyrë financimi e DHS-së ndikon në pavarësinë dhe paanësinë e saj. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se sistemi aktual i financimit jo vetëm që nuk vë në dyshim pavarësinë dhe paanësinë e DHS-së, por shërben për t'i siguruar asaj financim të vazhdueshëm dhe ndan veprimtarinë gjyqësore të DHS-së nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ, duke garantuar kështu pavarësinë dhe paanësinë e Dhomave të Specializuara. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se mënyra e përgjithshme e financimit dhe auditimit të DHS-së me përfshirjen e shteteve të treta kontribuese nuk vë në dyshim pavarësinë dhe paanësinë e Dhomave të Specializuara.

110. Në lidhje me punësimin e personelit të emëruar përmes autoriteteve shtetërore ose punësimin e personelit ndërkombëtar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se koncepti i pavarësisë përshtatet kundrejt pushtetit ekzekutiv, atij legjislativ dhe palëve.²¹⁴ Ky koncept zbatohet njësoj edhe ndaj argumentit të z. Selimi se praktikrat e punësimit të personelit ndërkombëtar në DHS ndikojnë në pavarësinë dhe paanësinë e saj, pasi ato përjashtojnë shqiptarët e Kosovës.²¹⁵ Megjithatë, z. Selimi nuk ka demonstruar më tej se në çfarë mënyre mungesa e shqiptarëve të Kosovës në radhët e personelit të DHS-së cenon pavarësinë dhe paanësinë e këtij institucioni. Veçanërisht, pretendimet e z. Selimi se punësimi i personelit ndërkombëtar e privon DHS-në nga

²¹³ Consultative Council of European Judges, Opinion No. 2, 23 November 2001, para. 5.

²¹⁴ *Shih më lart* para. I.99.

²¹⁵ Lidhur me argumentet e z. Selimi se praktikrat e punësimit të DHS-së janë diskriminuese pasi përjashtojnë shqiptarët e Kosovës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se ngritja e këtij pretendimi për diskriminim sipas nenit 14 të KEDNJ-së nuk ka të bëjë me të pasi ai nuk po kërkon të punësohet në DHS dhe, si rrjedhim, nuk është cenuar drejtpërdrejt nga praktika ndaj të cilës ankohet. *Shih, për ngjashmëri*, ECtHR, *Roman Zakharov v. Russia* [GC], no. 47143/06, [Judgment](#), 4 December 2015, para. 164.

“kultura dhe tradita e ndryshme shpirtërore dhe ligjore e Kosovës” ose se DHS-ja nuk është në favor të “dhënies së drejtësisë nga brenda” Kosovës janë vlerësime politike, por nuk dëmtojnë pavarësinë dhe paanësinë e DHS-së. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se punësimi i personelit të emëruar përmes autoriteteve shtetërore ose punësimi i personelit ndërkombëtar nuk vë në dyshim pavarësinë dhe paanësinë e DHS-së.

111. Duke marrë parasysh sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hedh poshtë kundërshtimet e z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi në lidhje me pavarësinë dhe paanësinë e DHS-së.

3. E drejta për të mos u gjykuar nga një gjykatë e jashtëzakonshme

112. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje parashtrimet e z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi sipas të cilave Ligji, me atë përmbajtje që është shpallur, ka krijuar *de jure* dhe *de facto* një gjykatë të jashtëzakonshme, duke shkelur nenin 103(7) të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.²¹⁶

113. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh lidhjen e ngushtë reciproke midis kriterëve të “pavarësisë” dhe “paanësisë” dhe kriterit të gjykatës së themeluar me ligj.²¹⁷ Gjithashtu, GJEDNJ-ja ka konkluduar se “një organ gjyqësor i cili nuk plotëson kriteret e pavarësisë – veçanërisht nga pushteti ekzekutiv – dhe të paanësisë, as nuk mund të quhet “gjykatë”, sipas nenit 6(1) të KEDNJ-së.²¹⁸ Pasi arriti më lart në përfundimin se DHS-ja është e themeluar me ligj²¹⁹ dhe se pavarësia dhe paanësia e saj nuk mund të vihen në dyshim, as, ndër të tjera, nga procedurat e emërimit të gjykatësve e as nga fakti që Dhomat e Specializuara

²¹⁶ Mocioni i Thaçit, para. 41-43; Mocioni i Veselit, para. 1-2, 5-12, 20; Mocioni i Selimit, para. 5-20.

²¹⁷ ECtHR, [Guðmundur Andri Ástráðsson v. Iceland \[GC\]](#), para. 231.

²¹⁸ ECtHR, [Guðmundur Andri Ástráðsson v. Iceland \[GC\]](#), para. 232.

²¹⁹ *Shih më lart* para. I.86-I.88.

mbështeten në një ligj të veçantë,²²⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se pretendimi se Dhomat e Specializuara janë *de facto* një gjykatë e jashtëzakonshme që funksionojnë në shkelje të nenit 103(7) të Kushtetutës nuk ka asnjë bazë.²²¹

114. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, në kundërshtim me parashtrimet e z. Veseli,²²² juridiksioni i DHS-së nuk kufizohet në një çështje gjyqësore, vepër penale ose kryes të vetëm; përkundrazi, Dhomat e Specializuara u themeluan për të gjykuar krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, që përmendeshin në Raportin e Këshillit të Evropës, të kryera nga 1 janari 1998 deri më 31 dhjetor 2000.²²³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, ndonëse juridiksioni i Dhomave të Specializuara nuk është i pakufizuar, është megjithatë mjaftueshmërisht i përgjithshëm dhe abstrakt për të përfshirë një mori krimesh dhe kategorish kryesish të tyre brenda kufijve të tij.²²⁴ Rrjedhimisht, nuk mund të thuhet se Dhomat e Specializuara janë një gjykatë e jashtëzakonshme me arsyetimin se ndjekin një qëllim të vetëm.

115. Për sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se Dhomat e Specializuara nuk funksionojnë si një gjykatë e jashtëzakonshme *de facto*, dhe, rrjedhimisht, hedh poshtë parashtrimet e z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi në lidhje me këtë aspekt.

²²⁰ Shih më lart para. I.99-I.111.

²²¹ Shih gjithashtu Aktvendimi i GJKK-së, para. 45-53.

²²² Mocioni i Veselit, para. 8-9.

²²³ Neni 162(1) i Kushtetutës; Nenet 1(2), 6(1), 7, 9 dhe 13-15 të Ligjit.

²²⁴ Venice Commission, *Opinion on the Draft Law on Anti-Corruption Courts and on the Draft Law on Amendments to the Law on the Judicial System and the Status of Judges (Concerning the Introduction of Mandatory Specialisation of Judges on the Consideration of Corruption and Corruption-Related Offences)* ("Opinion no. 896/2017"), Opinion no. 896/2017, 9 October 2017, para. 23-24. Shih gjithashtu, Venice Commission, *Final Opinion on the Revised Draft Constitutional Amendments on the Judiciary of Albania*, Opinion no. 824/2015, 14 March 2016, para. 63.

4. E drejta për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme

116. Z. Thaçi parashtron se të drejtat e tij njerëzore themelore të mishëruara në nenin 31(2) të Kushtetutës, sipas shembullit të nenit 6 të KEDNJ-së, janë shkelur për shkak të tejzgjatjes së procesit penal ndaj tij.²²⁵ Në këtë aspekt, z. Thaçi argumenton se, përderisa koncepti i “akuzës penale” në nenin 6(1) të KEDNJ-së duhet kuptuar në kuptimin “e të drejtës penale materiale” dhe jo “formal”, ai ishte “akuzuar” që nga data 7 janar 2011, që është data e publikimit të Raportit të Këshillit të Evropës.²²⁶ Në veçanti, z. Thaçi parashtron se që nga ajo datë, ai ka jetuar nën një “re të zezë” dyshimi nga publiku²²⁷ që ka ndikuar “juridikisht” ndaj tij, në kuadër të vërtetimit të ekzistencës së një akuze. Rrjedhimisht, z. Thaçi parashtron se procesi kundër tij është duke u zhvilluar që prej më shumë se dhjetë vjetësh, një periudhë kjo që është tejzgjatur në mënyrë të paarsyeshme dhe bie ndesh me standardet e KEDNJ-së.²²⁸

117. Gjithashtu, z. Thaçi vë në dukje se, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, për të parashtruar një pretendim për shkeljen e të drejtës themelore të një personi për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme, nuk është e nevojshme të pritët përfundimi i procesit penal.²²⁹ Ai parashtron se për të gjykuar mbi arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit, krahas asaj se çfarë rrezikon vetë personi, duhet vlerësuar edhe kompleksiteti i çështjes gjyqësore, veprimet e parashtruesit dhe të autoriteteve përkatëse dhe të drejtat e viktimave.²³⁰ Gjithashtu, z. Thaçi argumenton se për të vlerësuar nëse vonesa e shkaktuar është e arsyeshme, duhet të merret parasysh edhe koha e konsiderueshme që ka kaluar nga ngjarjet përkatëse si dhe vonesat që mund të ndodhin në të ardhmen.²³¹

²²⁵ Mocioni i Thaçit, para. 7-29.

²²⁶ Mocioni i Thaçit, para. 11-14.

²²⁷ Mocioni i Thaçit, para. 14.

²²⁸ Mocioni i Thaçit, para. 14, 20.

²²⁹ Mocioni i Thaçit, para. 15.

²³⁰ Mocioni i Thaçit, para. 18-29.

²³¹ Mocioni i Thaçit, para. 19, 21-22.

118. Në këtë aspekt, ndonëse pranon se çështja ndaj tij mund të cilësohet si një çështje gjyqësore komplekse, z. Thaçi parashtron se EULEX-i ka treguar një mungesë zelli që bëri që Dhomat e Specializuara të themeloheshin me një vonesë të konsiderueshme.²³² Z. Thaçi parashtron se ai nuk ka përgjegjësi për një vonesë të tillë pasi nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për të ngadalësuar procesin para arrestimit të tij në nëntor 2020.²³³ Sa u përket vonesave të shkaktuara nga autoritetet përkatëse, z. Thaçi parashtron se ai aktualisht nuk mund të vlerësojë nëse përgjegjësia për këto vonesa bie mbi prokurorinë.²³⁴ Së fundi, z. Thaçi parashtron se ai mund të marrë një dënim me burgim të gjatë dhe, si rrjedhim, kjo çështje është vetvetiu me rëndësi vendimtare për të.²³⁵

119. ZPS-ja përgjigjet se mosushtrimi i juridiksionit prej një gjykate përligjet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur ndodhin shkelje shumë të rënda të të drejtave të njeriut.²³⁶ Duke qenë se në çështjen në fjalë nuk ka ndodhur një gjë e tillë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk duhet të trajtojë themelësinë e pretendimeve të z. Thaçi.²³⁷

120. Sidoqoftë, ZPS-ja parashtron se as publikimi i Raportit të Këshillit të Evropës dhe as ndonjë zhvillim tjetër nuk përbënin “akuzë penale” në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së.²³⁸ ZPS-ja mbron pikëpamjen se z. Thaçi “u ndikua juridikisht” vetëm më 17 nëntor 2019, kur atij iu dorëzua fletëthirrja e ZPS-së për t’u paraqitur për një intervistë.²³⁹ Në këtë aspekt, ZPS-ja parashtron se Raporti i Këshillit të Evropës nuk pasqyronte një hetim penal por vetëm shprehte pikëpamjet e një organi politik.²⁴⁰ ZPS-ja më tej parashtron se para 17 nëntorit 2019, asnjë autoritet kompetent nuk kishte

²³² Mocioni i Thaçit, para. 23-25.

²³³ Mocioni i Thaçit, para. 26.

²³⁴ Mocioni i Thaçit, para. 27.

²³⁵ Mocioni i Thaçit, para. 29.

²³⁶ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 26.

²³⁷ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 27.

²³⁸ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 34.

²³⁹ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 34.

²⁴⁰ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 35-36.

marrë ndonjë masë, ose duke njoftuar zyrtarisht z. Thaçi për akuzat penale ndaj tij, ose që ndikoi juridikisht ndaj tij.²⁴¹ Sipas ZPS-së, një i akuzuar mund të ankohet për faktin se nuk po gjykohet brenda një kohe të arsyeshme vetëm pasi të ketë nisur “procesi gjyqësor” ndaj tij ose saj, pasi neni 6 i KEDNJ-së nuk e mbron një person nga opinioni publik apo nga dyshimi i përgjithshëm.²⁴²

121. Sa i përket kohëzgjatjes së procesit, ZPS-ja parashtron se ajo ka qenë plotësisht e arsyeshme.²⁴³ ZPS-ja parashtron se çështja gjyqësore kundër z. Thaçi përfshin akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit që pretendohet se janë kryer nga të akuzuar të shumtë përgjatë një periudhe të gjatë kohe.²⁴⁴ Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se numri i madh i dëshmitarëve dhe provave si dhe vështirësitë e hasura në mbledhjen e një materiali të tillë provues përforcojnë konstatimin se kohëzgjatja e procesit ka qenë e arsyeshme.²⁴⁵ Së fundi, ZPS-ja rikujton se Aktakuza u dorëzua vetëm pak muaj pasi z. Thaçi ishte vënë në dijeni për hetimin penal ndaj tij.²⁴⁶

122. Z. Thaçi kundërpërgjigjet se koncepti “autoritet kompetent” nuk bazohet në jurisprudencën e GJEDNJ-së.²⁴⁷ Përkundrazi, jurisprudenca e GJEDNJ-së mbështet pikëpamjen se një person mund të “ndikohet juridikisht” para paraqitjes zyrtare të akuzave.²⁴⁸ Në këtë aspekt, z. Thaçi parashtron se në Raportin e Këshillit të Evropës, ai ishte identifikuar qartë si “i dyshuar kryesor”²⁴⁹ dhe ishte vendosur nën dyshimin e përgjithshëm publik nga të paktën janari 2011, që është koha kur u publikua Raporti

²⁴¹ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 37.

²⁴² Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 38.

²⁴³ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 39.

²⁴⁴ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 40.

²⁴⁵ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 40.

²⁴⁶ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 40.

²⁴⁷ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 22.

²⁴⁸ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 23.

²⁴⁹ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 24.

i Këshillit të Evropës.²⁵⁰ Së fundi, z. Thaçi përsërit se ZPS-ja duhet të konsiderohet përgjegjëse për tejzgjatjen e procesit.²⁵¹

123. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se neni 21 i Ligjit, ashtu si neni 6 i KEDNJ-së, parashikon që, në shqyrtimin e akuzës penale kundër tij, i akuzuari gëzon të drejtën, ndër të tjera, të gjykohet brenda një kohe të arsyeshme. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje jurisprudencën e gjerë të GJEDNJ-së, e cila përcakton se në çështjet penale, “koha e arsyeshme” që përmendet në nenin 6(1) të KEDNJ-së, fillon sapo personi “akuzohet”.²⁵² GJEDNJ-ja ka saktësuar se koncepti i “akuzës penale” është koncept i të drejtës materiale dhe jo formal.²⁵³ Si rrjedhim, “akuza penale” ekziston që prej momentit kur personi njoftohet zyrtarisht nga autoriteti kompetent për pretendimin se ka kryer një vepër penale, ose që prej momentit kur situata e atij personi ndikohet juridikisht nga veprimet e ndërmarra prej autoriteteve si rrjedhojë e dyshimit kundër tij.²⁵⁴ Për rrjedhojë, garancitë mbrojtëse që ofron neni 6(1) i KEDNJ-së, duke përfshirë të drejtën për t’u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme, zbatohen për një person që është objekt i një akuze penale.

124. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren më tej se GJEDNJ-ja ka konstatuar në disa raste se një person kishte qenë objekt i një akuze penale edhe para se të akuzohej zyrtarisht, për shembull, kur ishte hapur një hetim paraprak dhe, ndonëse jo nën

²⁵⁰ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 25.

²⁵¹ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 27-28.

²⁵² *Shih ndër të tjera*, ECtHR, *Neumeister v. Austria*, no. 1936/63, [Judgment](#), 27 June 1968, para. 18.

²⁵³ *Shih ndër të tjera*, ECtHR, *Adolf v. Austria*, no. 8269/78, [Judgment](#), 26 March 1982, para. 30.

²⁵⁴ ECtHR, *Ibrahim and Others v. the United Kingdom* [GC], nos. 50541/08, 50571/08, 50573/08 and 40351/09, [Judgment](#), 13 September 2016, para. 249; *Liblik and Others v. Estonia*, nos. 173/15, 181/15, 374/15, 383/15, 386/15 and 388/15, [Judgment](#), 28 May 2019, para. 90.

arrest, i dyshuari ishte njoftuar zyrtarisht për hetimin ose gjendja e tij kishte filluar të ndikohej prej tij²⁵⁵ ose kur një i dyshuar ishte marrë në pyetje nga policia.²⁵⁶

125. Sidoqoftë, duke zbatuar parimet e lartpërmendura në rastin aktual, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk pajtohet me pretendimin kryesor të z. Thaçi se ai u “ndikua juridikisht” që nga data 7 janar 2011, kur u publikua Raporti i Këshillit të Evropës. Në veçanti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Raporti i Këshillit të Evropës është një raport që buron nga një organ jogjyqësor dhe autori i tij, në atë kohë anëtar i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, kishte saktësuar shprehimisht se nuk kishte mandatin dhe burimet e nevojshme për të kryer një hetim penal.²⁵⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk mund të konsiderohet se z. Thaçi ishte njoftuar zyrtarisht në atë kohë se do të ndiqej penalisht²⁵⁸ pasi asnjë gjykatë penale nuk kishte filluar ndonjë proces ndaj tij dhe as z. Thaçi nuk ishte njoftuar për ndonjë hetim penal ndaj tij.²⁵⁹ Rrjedhimisht, nuk mund të thuhet se z. Thaçi u “ndikua juridikisht” në kuadër të ekzistencës së një akuze penale, nga publikimi i Raportit të Këshillit të Evropës.

126. Përkundrazi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se data në të cilën z. Thaçi u “ndikua juridikisht” nga veprimet e ndërmarra nga autoritetet e DHS-së si rezultat i dyshimeve ndaj tij, ishte 17 nëntori 2019, që ishte data në të cilën atij iu dorëzua fletëthirrja për t’u paraqitur për një intervistë me ZPS-në. Në atë datë, z. Thaçi

²⁵⁵ ECtHR, *Eckle v. Germany*, no. 8130/78, [Judgment](#), 15 July 1982, para. 74; *shih gjithashtu Corigliano v. Italy*, no. 8304/1978, [Judgment](#), 10 December 1982, para. 34-35, ku gjykata konsideroi si datë fillimi datën në të cilën njoftimi gjyqësor për hetimin iu dorëzua parashtuesit dhe jo datën në të cilën kishte filluar hetimi.

²⁵⁶ ECtHR, *Svinarenko and Slyadnev v. Russia* [GC], nos. 32541/08 and 43441/08, [Judgment](#), 17 July 2014, para. 141; *Yankov and Others v. Bulgaria*, no. 4570/05, [Judgment](#), 23 September 2010, para. 23; *Aleksandr Zaichenko v. Russia*, no. 39660/02, [Judgment](#), 18 February 2010, para. 41-43.

²⁵⁷ Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, *Raport mbi Trajtimin Çnjerëzor të Personave dhe Trafikimin e Paligjshëm të Organeve Njerëzore në Kosovë*, Dok. 12462, 7 janar 2011.

²⁵⁸ *Shih, për ngjashmëri*, ECtHR, *Rezov v. Bulgaria*, no. 56337/00, [Judgment](#), 15 February 2007, para. 49-50.

²⁵⁹ *Shih* ECtHR, *Pedersen and Baadsgaard v. Denmark*, no. 49017/99, [Judgment](#), 17 December 2004, para. 44, ku parashtuesit e dinin që ishin raportuar në polici, por u informuan se ende nuk ishte marrë asnjë vendim në lidhje me akuzat e mundshme ndaj tyre.

mësoi zyrtarisht se ZPS-ja po hetonte në lidhje me krimet e pretenduara të kryera nga ai dhe, si rrjedhim, kjo ishte data kur ai “u akuzua penalisht” në kuptim të nenit 6(1) të KEDNJ-së. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se njoftimi zyrtar lidhur me pretendimin se z. Thaçi kishte kryer një vepër penale, pasoi fletëthirrjen e përmendur më sipër, dhe u bë me anë të konfirmimit të Aktakuzës e cila iu njoftua z. Thaçi më 19 nëntor 2020.²⁶⁰

127. Rrjedhimisht, perioda që duhet të merret parasysh për të përcaktuar sa e arsyeshme ka qenë kohëzgjatja e procesit, filloi më 17 nëntor 2019. Procesi penal, i cili është ende duke u zhvilluar, ka zgjatur përafërsisht një vit e nëntë muaj.

128. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit duhet të vlerësohet duke pasur parasysh rrethanat e çështjes gjyqësore dhe duke iu referuar kritereve të mëposhtme: (i) kompleksitetit të çështjes gjyqësore; (ii) veprimeve të parashtruesit të kërkesës dhe të autoriteteve përkatëse; dhe (iii) me çfarë pasojash përballet parashtruesi i mocionit.²⁶¹ Arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit varet nga një numër elementesh që duhet të shqyrtohen së bashku.²⁶²

129. Lidhur me kompleksitetin e çështjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se z. Thaçi përballet me një numër akuzash për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte, në lidhje me ngjarje që përfshijnë vende të shumta në Kosovë dhe Shqipëri e që kanë ndodhur brenda një periudhe të gjatë kohe.²⁶³ Gjithashtu, ndër të tjera, vëllimi i provave dhe shumëllojshmëria e çështjeve ligjore të përfshira,²⁶⁴ e ndërlikojnë këtë çështje gjyqësore. Për sa u takon veprimeve të palëve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se ai së fundmi ka konstatuar se të gjithë hapat proceduralë në

²⁶⁰ *Shih* Vendimi i Konfirmimit.

²⁶¹ *Shih, ndër shumë burime ligjore të tjera*, ECtHR, *Kalēja v. Latvia*, no. 22059/08, [Judgment](#), 5 October 2017, para. 42. *Shih, për ngjashmëri*, Vendimi në lidhje me hetimin kundër z. Lajçi para. 28.

²⁶² *Ngjashëm*, ICTR, *Prosecutor v. Bizimunguet al.*, ICTR-99-50-T, Trial Chamber II, [Decision on Prosper Mugiraneza's Third Motion to Dismiss Indictment for Violation of his Right to a Trial Without Undue Delay](#), 10 February 2009, para. 12 dhe poshtëshënimi 18, me referenca të mëtejshme.

²⁶³ Vendimi i Konfirmimit, para. 521(a).

²⁶⁴ Siç demonstronhet, *për shembull*, nga Vendimi mbi Mocionet në lidhje me Juridiksionin.

lidhje me fazën paraprake të kësaj çështjeje kanë përfunduar, po përfundojnë ose do të përfundojnë me synimin për t'ia kaluar çështjen trupit gjykues për gjykim në një të ardhme të afërt dhe se afatet përkatëse, ose janë përmbushur ose janë zgjatur në disa raste për arsye të vlefshme.²⁶⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i ndërgjegjshëm se z. Thaçi është në paraburgim dhe si rrjedhim kërkohet që autoritetet të tregojnë “zell të veçantë” në trajtimin e çështjes së tij.²⁶⁶ Për më tepër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i vetëdijshëm për pasojat vetiu serioze me të cilat përballet z. Thaçi, pasi nëse shpallet fajtor, ai mund të dënohet me burgim të gjatë, përfshirë burgimin e përjetshëm. Pavarësisht nga çfarë rrezikon z. Thaçi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kohëzgjatja e procesit penal ndaj z. Thaçi deri më tani ka qenë e arsyeshme, dhe çdo diskutim në lidhje me kohëzgjatjen e përgjithshme të pritshme të procesit në këtë fazë është i parakohshëm dhe hamendësues.

130. Duke u bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se e drejta e z. Thaçi për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme, nuk është shkelur dhe, rrjedhimisht, ai hedh poshtë argumentet e z. Thaçi në lidhje me shkeljen e pretenduar të kësaj të drejte.

5. E drejta për t'u konsideruar i pafajshëm

131. Z. Thaçi parashtroi se mbështetja e hapët që Dhomat e Specializuara i bënë Raportit të Këshillit të Evropës, i cili përmban fjalë dhe konstatime të cilat pasqyrojnë qartë mendimin se ai ishte fajtor para se fajësia e tij të provohej ligjërisht, është një shkelje e qartë e parimit të prezumimit të pafajësisë të përcaktuar në nenin 31(5) të Kushtetutës dhe në nenin 6(2) të KEDNJ-së.²⁶⁷

²⁶⁵ KSC-BC-2020-06, F00417/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 23 korrik 2021, publik, para. 61.

²⁶⁶ ECtHR, *Abdoella v. the Netherlands*, no. 12728/87, [Judgment](#), 25 November 1992, para. 24.

²⁶⁷ Mocioni i Thaçit, para. 30-35.

132. Z. Thaçi u referohet shprehimisht pjesëve të veçanta të Raportit të Këshillit të Evropës²⁶⁸ dhe parashtron se ky i fundit e dënon hapur atë pasi nuk përmban ndonjë vërejtje apo paralajmërim se akuzat që përmban raporti nuk janë provuar në gjykatë dhe as që personat e përmendur në të nuk kanë pasur mundësi të kundërpërgjigjen në lidhje me ato akuza.²⁶⁹ Z. Thaçi parashtron se “bekimi” që Dhomat e Specializuara i japin Raportit të Këshillit të Evropës si një “Dokument Themelor” bie ndesh me të drejtën e tij për t’u konsideruar i pafajshëm.²⁷⁰

133. ZPS-ja përgjigjet se Raporti i Këshillit të Evropës bën të qartë se detyra e tij nuk ishte të kryente një hetim penal, e aq më pak të shpallte vendime për pafajësi apo fajësi.²⁷¹ Gjithashtu, ZPS-ja thekson se Raporti i Këshillit të Evropës përmban disa vërejtje të cilat paralajmërojnë lexuesit se në lidhje me pretendimet nuk ishte kryer hetim penal.²⁷²

134. ZPS-ja më tej rikujton se Raporti i Këshillit të Evropës është pjesë e kornizës ligjore që rregullon juridiksionin e Dhomave të Specializuara dhe se nuk kishte asgjë paragjyquese në faktin se DHS-ja i referohej një dokumenti të cilit i referohet Ligji.²⁷³ Sidoqoftë, ZPS-ja parashtron se Raporti i Këshillit të Evropës nuk ishte një deklaratë nga një përfaqësues ose autoritet i ndonjë shteti me juridiksion në lidhje me këtë çështje dhe se z. Thaçi nuk ishte i akuzuar për ndonjë vepër penale në kohën e publikimit të tij; si rrjedhim nuk mund të zbatohen garancitë e parashikuara sipas nenit 31(5) të Kushtetutës dhe nenit 6(2) të KEDNJ-së.²⁷⁴

135. Z. Thaçi kundërpërgjigjet se paralajmërimet e kujdesshme të përmendura nga ZPS-ja duhen peshuar kundrejt disa pretendimeve “të papërgjegjshme” që përmbante

²⁶⁸ Mocioni i Thaçit, para. 32.

²⁶⁹ Mocioni i Thaçit, para. 33.

²⁷⁰ Mocioni i Thaçit, para. 34.

²⁷¹ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 29.

²⁷² Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 30-31.

²⁷³ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 32.

²⁷⁴ Përgjigjja e ZPS-së, F260, para. 33.

Raporti i Këshillit të Evropës, të cilat e përshkruanin atë qartësisht si fajtor.²⁷⁵ Sa i përket argumentit të ZPS-së se Raporti i Këshillit të Evropës nuk ishte një deklaratë nga një përfaqësues ose autoritet i ndonjë shteti me juridiksion në lidhje me këtë pikë, z. Thaçi kundërpërgjigjet se nuk është vetëm Raporti i Këshillit të Evropës që shkel supozimin e pafajësisë së tij, por më tepër është mbështetja e pretenduar që Dhomat e Specializuara i dhanë atij.²⁷⁶ Në këtë aspekt, z. Thaçi parashtron se parimi i supozimit të pafajësisë zbatohet për të gjitha deklaratat e bëra nga një autoritet publik.²⁷⁷

136. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se parimi i supozimit të pafajësisë është një element themelor i së drejtës për një gjykim të drejtë penal dhe mbrohet, ndër të tjera, nga neni 6(2) i KEDNJ-së dhe neni 31(5) i Kushtetutës, ku kjo e fundit është përgatitur sipas modelit të KEDNJ-së.²⁷⁸ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se parimi i supozimit të pafajësisë shkelet, ndër të tjera, nëse një deklaratë e një zyrtari publik në lidhje me një person të akuzuar për një vepër penale pasqyron mendimin se ai person është fajtor para se të jetë provuar ligjërisht.²⁷⁹ Në këtë kuptim, GJEDNJ-ja ka konstatuar vazhdimisht se parimi i supozimit të pafajësisë mund të shkelet jo vetëm nga një gjykatës ose gjykatë, por edhe nga autoritete të tjera publike.²⁸⁰ Si rrjedhim, fushëveprimi i garancive mbrojtëse të parimit të supozimit të pafajësisë shtrihet në të gjitha deklaratat e bëra nga një autoritet publik, pavarësisht nëse ato janë bërë në kuadër të një gjykimi penal, në një mjedis tjetër publik ose në procese të tjera paralele gjyqësore.²⁸¹

²⁷⁵ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 17.

²⁷⁶ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 18-20.

²⁷⁷ Kundërpërgjigjja e Thaçit ndaj F260, para. 20.

²⁷⁸ *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, Transkripti, 19 May 2021, faqja 429, rreshtat 11-14.

²⁷⁹ *Shih, për shembull.*, ECtHR, *Allen v. the United Kingdom* [GC], no. 25424/09, [Judgment](#), 12 July 2013, para. 93; *Daktaras v. Lithuania*, no. 42095/98, [Judgment](#), 10 October 2000, para. 41.

²⁸⁰ *Shih, mes shumë të tjerash*, ECtHR, *Allenet de Ribemont v. France*, no. 15175/89, [Judgment](#), 10 February 1995, para. 36.

²⁸¹ ECtHR, *Kemal Coşkun v. Turkey*, no. 45028/07, [Judgment](#), 28 March 2017, para. 42.

137. Në këtë kuadër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se GJEDNJ-ja ka deklaruar vazhdimisht se, siç përcaktohet shprehimisht në vetë nenin, garancitë mbrojtëse që ofron neni 6(2) i KEDNJ-së të cilat i përshkruam më sipër zbatohen kur një person është “i akuzuar për një vepër penale” brenda kuptimit autonom të nenit 6 të KEDNJ-së.²⁸² Është konstatuar se në mungesë të “akuzës penale”,²⁸³ neni 6(2) i KEDNJ-së nuk mund të zbatohet. Kjo është veçanërisht e vërtetë në rastet kur mbrojtja që garanton neni 6(2) i KEDNJ-së kërkohet të zbatohet ndaj deklaratave që pretendohet të jenë paragjyquese, të bëra në lidhje të ngushtë me procesin penal. Kur nuk ka ose nuk ka pasur procese të tilla, deklaratat që atribuojnë veprime kriminale ose veprime të tjera të dënueshme kanë më shumë të bëjnë me garancitë mbrojtëse ndaj shpifjes dhe me ngritjen e çështjeve të mundshme sipas nenit 8 të KEDNJ-së.²⁸⁴

138. Gjatë zbatimit të parimeve të lartpërmendura në çështjen aktuale gjyqësore, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton konstatimet e bëra më lart prej tij në kontekstin e kohëzgjatjes së procesit, se data në të cilën z. Thaçi u ndikua juridikisht nga veprimet e ndërmarra nga autoritetet si pasojë e dyshimeve ndaj tij dhe që, si rrjedhim, është data kur ai u “akuzua” në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së, ishte data 17 nëntor 2019, data në të cilën atij iu dorëzua fletëthirrja për t’u paraqitur për një intervistë me ZPS-së.²⁸⁵

139. Për sa i përket Raportit të Këshillit të Evropës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se në kohën e publikimit të tij, në janar 2011, Dhomat e Specializuara as nuk ekzistonin e as nuk kishte filluar themelimi i tyre. Si rrjedhim, në atë kohë nuk po zhvillohej ndonjë proces gjyqësor ndaj z. Thaçi dhe ky i fundit nuk ishte “ndikuar juridikisht” në ndonjë mënyrë tjetër. Rrjedhimisht, ndaj konstatimeve të

²⁸² *Shih, mes shumë të tjerash, ECtHR, Larrañaga Arando v. Spain*, no. 73911/16, [Decision](#), 25 June 2019, para. 40, me referenca të mëtejshme.

²⁸³ *Shih më lart* para. I.123 për kuptimin e fjalës “akuzë” në jurisprudencën e GJEDNJ-së.

²⁸⁴ ECtHR, *Khodorkovskiy and Lebedev v. Russia* (No. 2), nos. 51111/07 dhe 42757/07, [Judgment](#), 14 January 2020, para. 543; *Ismoilov and Others v. Russia*, no. 2947/06, [Judgment](#), 24 April 2008, para. 160; *Zollmann v. the United Kingdom*, no. 62902/00, [Decision](#), 27 November 2003, para. 1.

²⁸⁵ *Shih më lart* para. I.126.

kundërshtuara të Raportit nuk zbatoheshin garancitë e parapara në nenin 6 të KEDNJ-së.

140. Gjithashtu, nuk mund të thuhet se konstatimet e kundërshtuara të Raportit kanë paragjykuar procesin e ardhshëm penal ndaj z. Thaçi dhe si rrjedhim ndaj tyre duhet të zbatohen garancitë e përmendura më sipër. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se Raporti i Këshillit të Evropës është paraqitur nga një organ jogjyqësor dhe se detyra e hartuesve të tij nuk ishte të kryenin një hetim penal.²⁸⁶ Kjo përforcohet edhe nga fakti që Raporti i Këshillit të Evropës nuk është përdorur për të mbështetur ndonjë nga akuzat penale të ngritura përfundimisht kundër z. Thaçi. Përkundrazi, akuzat aktuale rrjedhin nga një hetim i pavarur dhe i paanshëm penal.²⁸⁷

141. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se as përfshirja e Raportit të Këshillit të Evropës në “Dokumentet Themelore” të DHS-së dhe as përmendja e tij në nenet 1 dhe 6 të Ligjit, të cilat përcaktojnë juridiksionin lëndor të Dhomave të Specializuara, nuk përbëjnë shkelje të parimit të supozimit të pafajësisë në lidhje me z. Thaçi, përderisa asnjë autoritet publik, qoftë gjyqësor ose hetimor, e as ndonjë zyrtar tjetër publik që ka lidhje me DHS-së ose me proceset e saj, nuk ka bërë asnjëherë ndonjë deklaratë paragjyqëse ndaj z. Thaçi, pasi ky i fundit u “akuzua” penalisht. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk ka asgjë paragjyqëse në citimin e një raporti që thjesht i dha shtysën politike krijimit të një gjykate penale për të gjykuar krime të mundshme.²⁸⁸

²⁸⁶ *Shih më lart* para. I.125 dhe poshtëshënimi 257.

²⁸⁷ *Shih* Vendimi i Konfirmimit.

²⁸⁸ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se hetimet dhe misionet faktmbledhëse po përdoren vazhdimisht për t’iu përgjigjur situatave të shkeljeve të rënda të supozuara të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si dhe për të nxitur llogaridhënien për shkelje të tilla dhe luftuar pandëshkueshmërinë, *shih, për shembull*, listën e [United Nations Human Rights Council-mandated Commission of Inquiries and Fact-Finding Missions & Other Bodies](#).

142. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se e drejta e z. Thaçi për t'u konsideruar i pafajshëm nuk është shkelur dhe, rrjedhimisht, hedh poshtë të gjitha argumentet e tij në lidhje me shkeljen e pretenduar të kësaj të drejte.

6. Përfundim

143. Për sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se të drejtat kushtetuese të të akuzuarve nuk janë shkelur dhe, rrjedhimisht, konstaton se nuk ka asnjë bazë ligjore për mosushttrimin e juridiksionit prej Dhomave të Specializuara.

D. KËRKESA E VESELIT PËR REFERIM DHSGJK-SË

144. Sa i përket kërkesës së Veselit që çështja “nëse DHS-ja është kompetente për të gjykuar veprat penale të pretenduara [...] në një proces gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm, të çliruar nga ndikimi i palejueshëm politik dhe të bazuar në legjislacionin e Kosovës, në përputhje me Kushtetutën e Kosovës” t'i referohet DHSGJK-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se rregulla 75(5) e Rregullores përcakton që palët dhe mbrojtësi i viktimave nuk kanë të drejtë të paraqesin mocione për referim sipas nenit 49(4) të Ligjit dhe mocionet e paraqitura për këtë qëllim nuk do të merren në shqyrtim. Ndonëse palët nuk kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për këtë qëllim, asgjë nuk i pengon ato të nxisin Gjykatësin e Procedurës Paraprake që të ushtrojë kompetencën e tij diskrecionale dhe t'i referojë DHSGJK-së një çështje që ka lidhje me kushtetutshmërinë. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se rregulla 75(5) e Rregullores i mundëson një gjykatësi apo një paneli të përcaktojë me nismën e vet nëse do të bëjë referim në përputhje me nenin 49(4) të Ligjit.

145. Në rrethanat aktuale, z. Veseli nuk ka përcaktuar ndonjë dispozitë konkrete që nuk përputhet me Kushtetutën, por ka parashtuar se juridiksioni lëndor i Dhomave

të Specializuara, personeli i tyre ndërkombëtar, procedura për emërimin e gjykatësve dhe korniza ligjore e DHS-së e përparësia ndaj gjykatave të tjera ("Veçoritë e Përzgjedhura") mbështesin pretendimin se Dhomat e Specializuara janë një gjykatë e jashtëzakonshme që funksionon në shkelje të nenit 103(7) të Kushtetutës.²⁸⁹ Z. Veseli gjithashtu parashtron se GJKK-ja nuk kishte pasur më parë mundësinë për të shqyrtuar Ligjin dhe si rrjedhim tani ekzistojnë arsye bindëse për të rishikuar kushtetutshmërinë e Dhomave të Specializuara.²⁹⁰ Sidoqoftë, për arsyet e përmendura më sipër,²⁹¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka ndonjë pasiguri sa i përket kushtetutshmërisë së Veçorive të Përzgjedhura të DHS-së. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake refuzon të ushtrojë kompetencën e tij diskrecionale për t'ia referuar këtë çështje DHSGJK-së dhe, për rrjedhim, refuzon kërkesën e z. Veseli për referimin e saj tek DHSGJK-ja.

V. VENDIM

146. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **RRËZON** Mocionin e Thaçit mbi Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së për sa i takon kundërshtimit të mandatit kohor të DHS-së dhe ligjshmërisë së hetimit të ZPS-së;
- b. **RRËZON** Mocionin e Thaçit;
- c. **RRËZON** Mocionin e Veselit; dhe
- d. **RRËZON** Mocionin e Selimit.

²⁸⁹ Mocioni i Veselit, para. 1-2, 5-12.

²⁹⁰ Mocioni i Veselit, para. 3-4.

²⁹¹ *Shih më lart* para. I.101-I.111, I.114.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E martë, 31 gusht 2021
Në Hagë, Holandë.